



# RAPORTI I MONITORIMIT TË GJYKATAVE 2016







**AUTOR:**

Petrit Kryeziu

**Koordinator i Projektit të Monitorimit të Gjykatave**

Faik Ispahiu

**Menaxher i projektit të Monitorimit të Gjykatave dhe**

**Drejtor Ekzekutiv i Internews Kosova**

**MONITORUES:**

Labinot Leposhtica

Lekë Muqaj

Armend Zenelaj

Qazim Hasanaj

Skender Govori

Taulant Rracaj

Liridon Rama

Behar Mustafa

## PËRMBAJTJA

- Hyrje	7
- Metodologjia	8
- Trajtimi i paraburgimit, si problem në gjykatat e Kosovës	9
- Shkeljet procedurale gjatë seancave gjyqësore	23
- Dënimet me punë në dobi të përgjithshme	35
- Negocimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë në gjykatat e Kosovës 2015-2016	37
- Ndërmjetësimi si formë alternative e zgjidhjes së lëndëve në gjyqësor	42
- Hudhja e aktakuzës në shqyrtimin e dytë	48
- Të metat e ligjit të trashëgimisë në Kosovë	52
- Zyret për informim dhe transparenca	56
- Shkeljet teknike	61
- Rekomandimet	70



## HYRJE

Për të dhjetin vit me radhë, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (I/KS) vazhdojnë monitorimin e sistemit gjyqësor në Kosovë në të gjitha nivelet e gjykatave.

Ky raport fokus të veçantë do të ketë rastet e paraburgimit, por gjithashtu do të trajtojë probleme të tjera të vëzhguara gjatë punës së monitoruesve në teren.

Më konkretisht, raporti do të përmbajë analiza të hollësishme me rekomandime konkrete për tema si:

- negocimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë,
- ndërmjetësimi si formë alternative e zgjidhjes së lëndëve në gjyqësor,
- aplikimi i dënimeve me punë në dobi të përgjithshme,
- hedhja poshtë e aktakuzave në shqyrtimin e dytë,
- zyret për informim dhe transparencë, si dhe
- analiza e të metave të Ligjit të Trashëgimisë në Kosovë.

Për më shumë, raporti do theksojë shkeljet procedurale nga e drejta e të pandehurit për t'u informuar në gjuhën që e flet, mosmbajtja e rendit gjatë procesit gjyqësor, moskonstatimi i gjendjes reale në procesverbalin gjyqësor, moslargimi i dëshmitarëve nga salla e gjykimit, mosdërgimi i ftesave me rregull nga gjykata, mospërgatitja e prokurorëve për gjykim, caktimi i dy seancave gjyqësore në të njëjtën kohë, mbajtja e gjykimit pa përbërjen e plotë të trupit gjykues, sjellja me vonesë nga qendra e paraburgimit, ndërrimi i deklaratave të dëshmitarëve, mosrespektimi i afateve ligjore, e deri te shtyrjet e panevojshme të seancave gjyqësore dhe problemet teknike gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore.

Po ashtu, raporti do të ofrojë edhe të dhëna për transparencën dhe llogaridhënien për publikun nga ana e institucioneve të policisë, prokurorisë dhe gjykatave të Kosovës. Ky raport edhe këtë vit i është rikthyer shkeljeve teknike me të dhëna konkrete nga monitorimi i 686 seancave gjyqësore.

Në fund, raporti do të ofrojë edhe rekomandime konkrete për institucionet e përfshira në punën e gjyqësorit në Kosovë.

## METODOLOGJIA

Gjatë përpilimit të këtij raporti janë përdorur metoda vëzhguese e drejtpërdrejtë, analizuese, krahasuese dhe statistikore, varësisht nga tema apo kapitulli i trajtuar.

Vëzhgimi i drejtpërdrejtë i punës së gjykatave bazohet në monitorimin e 686 seancave të monitoruara gjatë vitit 2016, me fokus të veçantë në rastet që ndërlidhen me raste të paraburgimit dhe seanca të natyrave të ndryshme gjyqësore.

Në vitin 2016, ekipi monitorues ka mbuluar të gjitha nivelet e gjykatave në Kosovë (shtatë gjykatat themelore dhe degët e tyre, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme).

Këto nivele janë monitoruar në Gjykatat e shpërndara në komunat: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjiilan, Ferizaj, Vushtrri, Skënderaj, Drenas, Kaçanik, Viti, Podujevë, Rahovec, Suharekë, Klinë, Istog, Gjakovë, Deçan, Dragash, Lipjan, Kamenicë, Novobërdë dhe Malishevë.

Përfshirë 686 seancat e monitoruara gjatë vitit 2016, numri i përgjithshëm i seancave të monitoruara në projektin e monitorimit të gjykatave ka arritur në 10,482, duke krijuar kështu një bazë të fuqishme të dhënash që mundëson bërjen e analizave krahasuese dhe matjen e trendeve dhe progresit të arritur.

### Tabela me numrin e përgjithshëm të seancave gjyqësore të monitoruara:

2008/2009	2009/2010	2010/2011	2011	2012
<b>513</b>	<b>1,248</b>	<b>2,147</b>	<b>2,525</b>	<b>1,441</b>
SEANCA	SEANCA	SEANCA	SEANCA	SEANCA
2013	2014	2015	2016	TOTAL
<b>820</b>	<b>501</b>	<b>600</b>	<b>686</b>	<b>10,481</b>
SEANCA	SEANCA	SEANCA	SEANCA	SEANCA



## TRAJTIMI I PARABURGIMIT, SI PROBLEM NË GJYKATAT E KOSOVËS

Gjatë vitit 2015- 2016, monitoruesit e BIRN dhe I/KS fokus të veçantë kanë pasur në rastet nga procedura paraprake, si dhe raste të shqyrtimit kryesor që kanë të bëjnë me persona të dyshuar të veprave penale të ndodhur në paraburgim.

Monitorimi i BIRN dhe I/KS gjatë vitit 2015- 2016 ka qenë pikë përqendrimi sa u përket rasteve të paraburgimit duke i vlerësuar si rastet më të rëndësishme në procedurë penale, ngase kjo ka të bëjë drejtpërdrejt me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara edhe me konventa europiane.

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) i ka kushtuar rëndësi të veçantë masës së paraburgimit në mënyrë që organet e gjyqësorisë t'i peshojnë si duhet dhe sa duhet arsyet në çdo rast ku mendojnë të caktojnë paraburgimin. Sipas KEDNJ-së: "Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht".<sup>1</sup> Edhe ligji vendor i zbatueshëm në Kosovë në mënyrë të ngjashme përcakton që "Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përpos rasteve dhe në pajtim me procedurën e përcaktuar me ligj".<sup>2</sup> Në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës parashihen nëntë masa të cilat mund të përdoren për të siguruar praninë e të pandehurit, për pengimin e rikryerjes së veprës penale dhe për zbatimin e suksesshëm të procedurës penale.<sup>3</sup> Me rastin e vendosjes se cila nga masat do të zbatohet për të siguruar praninë e të pandehurit, gjykata detyrohet t'i marrë parasysh kushtet e përcaktuara për masat konkrete dhe të sigurojë që të mos zbatohet masë më të rëndë kur mjafton masa më e butë. Masa e paraburgimit është e listuar si masa e fundit për sigurinë e prezencës së të pandehurit në procedurë, mirëpo në praktikë kjo masë në të shumtën e rasteve përdoret si masa e parë dhe e vetme.

BIRN dhe I/KS (në tekstin e mëposhtëm Raporti) kanë vërejtur se në disa raste prokurorët nuk kanë arritur të dëshmojnë dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale, ndërsa vetëm kanë parafrazuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale pa u ndërlidhur me rrethanat specifike të rastit dhe pa u thirrur në argumente konkrete që dëshmojnë se paraburgimi i të pandehurit është vërtetë i domosdoshëm.

Pos monitorimit të rasteve konkrete, gjatë hulumtimit janë marrë edhe opinione nga zbatuesit e drejtpërdrejtë të praktikës gjyqësore si gjykatës, prokurorë dhe avokatë. Duke pasur parasysh dëshirën e secilit avokat që ta fitojë rastin, sidomos te paraburgimi, opinionet e tyre janë që, në të shumtën e rasteve, prokurori i shtetit në kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit i paraqet të tri bazat kryesore të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës<sup>4</sup> dhe kjo vetëm e vetëm për ta arritur qëllimin e caktimit të paraburgimit. Në ndërkohë shihet qartë se në realitet ekziston vetëm njëra bazë apo asnjëra nga to dhe në pamundësi që ta argumentojnë në tërësi kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit, prokurorët në të shumtën e rasteve përdorin edhe bazat tjera vetëm për ta arritur qëllimin për caktimin e paraburgimit: 1.1. ekziston dyshim i bazuar se personi i fillë ka kryer vepër penale; 1.2. përmbushet njëri nga kushtet e mëposhtme:

1 Shih neni 6 par.2 i KEDNJ-së.

2 Shih neni 12 par. 1 i KPPRK-së.

3 Shih neni 173 i KPPRK-së.

4 Shih neni 187 par. 1 i KPRK-së.

1.2.1. kur ai fshihet, kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që tregojnë se ekziston rrezik i ikjes së tij; 1.2.2. kur ka arsye për të besuar se ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit; ose 1.2.3. kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund ta përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryejë.

Fatkeqësisht në praktikë, nga prokuroria janë të rralla rastet kur kërkohet aplikimi i ndonjë mase tjetër për sigurinë e prezencës së të pandehurit në procedurë. Pothuajse të gjitha kërkesat janë për caktimin e masës së paraburgimit.

Ndërsa avokatët, në të shumtën e rasteve kur besojnë se ka prova të mjaftueshme që klienti i tyre ka mundur ta kryejë veprën penale, preferojnë arrestin shtëpiak pasi që kjo masë llogaritet si dënim në përfundim. Mirëpo avokatët thonë se kjo varet çdo herë nga kërkesa e prokurorit dhe pavarësisht të drejtës për barazi të palëve<sup>5</sup>, gjykata megjithatë përparësi në të shumtën e rasteve thonë se u jep kërkesave të prokurorëve pa marrë parasysh arsyetimet e tyre.

Edhe gjyqtarët në opinionet e tyre dhënë për Raportin thonë se prokurorët për sigurinë e prezencës së të pandehurit në procedurë zakonisht kërkojnë masën e paraburgimit ndërsa anashkalojnë kërkesat për masë tjetër.

Gjyqtarët thonë se prokurorët thirren vetëm në pikat e Kodit të Procedurës Penale, duke anashkalluar faktin që secili rast përmban karakteristikat e veçanta të cilat duhet të arsyetohen mirë. Në opinionet e tyre, gjyqtarët thonë se rrallëherë i refuzojnë propozimet e prokurorëve për caktimin e masës së paraburgimit edhe atëherë kur ato propozime nuk janë të arsyetuara mirë, gjë për të cilat barra më e rëndë u bie vet gjyqtarëve me rastin e arsyetimit të vendimit.

Nga ana tjetër, prokurorët ankohen në mungesën e azhuritit të policisë në raport me prokurorinë, për sa i përket afatit 24 orësh pas arrestimit të të dyshuarit për kryerje të veprës penale<sup>6</sup>.

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës parasheh që brenda njëzetekatër (24) orëve pas arrestimit të të dyshuarit, prokurori i shtetit t'i paraqesë gjyqtarit të procedurës paraprake kërkesën për caktimin e paraburgimit.<sup>7</sup> Prokurorët thonë se në praktikë shpesh ballafaqohen me problemin e mos-azhuritit të policisë ndaj personave të ndaluar nga prokurori, të cilët kallëzimet penale i dorëzojnë në prokurori vetëm pak para se të skadojë afati 24 orësh për paraqitjen e kërkesës në gjykatë dhe kallëzimet penale në të shumtën e rasteve sipas prokurorëve paraqiten me prova të zbehta.

<sup>5</sup> Sipas nenit 9 të KPPRK-së, i pandehuri dhe prokurori i shtetit në procedurë penale kanë pozitë të barabartë.

<sup>6</sup> Shih faqet 7, 8 dhe 9 të këtij Raporti.

<sup>7</sup> Shih neni 164 par. 7 i KPPRK-së.

Prokurorët thonë se ka raste të shpeshta kur policia dërgon kallëzime penale vetëm dy orë para skadimit të afatit 24 orësh, periudhë brenda së cilës prokurori është i obliguar që pajtëtar të paraqesë kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit te gjyqtari i procedurës paraprake. Kjo, sipas prokurorëve, ndikon në mos arsyetimin e duhur të propozimeve për caktimin e masës së paraburgimit, që në raste të caktuara thonë se gjykata refuzon kërkesat e prokurorit ose i hedh krejt si të pabazuara.<sup>8</sup>

Raporti, gjatë procesit të monitorimit të rasteve të paraburgimit, ka gjetur parregullsi të shumta të cilat janë listuar në katër pika:

- a) vonesat e kallëzimeve penale nga policia në prokurori;
- b) dështimi i arsyetimeve të vendimeve për caktimin e masës së paraburgimit, si nga prokuroria ashtu edhe nga gjyqtarët e procedurës paraprake;
- c) stërzgjatja e paraburgimeve në pritje të gjykimit të të akuzuarëve si dhe
- d) mos respektimi i afateve gjyqësore për caktimin e shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimit të dytë.

Për të gjitha pikat e lartëcekura, BIRN dhe I/KS kanë marrë shembuj konkretë për të elaboruar gjendjen në teren.

### a) Vonesat e Kallëzimeve Penale

Raporti, gjatë monitorimit të rasteve të paraburgimit, si shqetësim ka parë çështjen e vonesave të dorëzimit të kallëzimeve penale nga ana e policisë në prokurori.

Sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, sapo policia të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, ajo është e detyruar që brenda njëzet e katër (24) orëve t'i dorëzojë një raport policor prokurorit të shtetit që është kompetent, i cili pastaj vendos nëse duhet filluar procedurën penale<sup>9</sup>.

Poashtu, Kodi i Procedurës Penale parasheh që brenda njëzetekatër (24) orëve pas arrestimit, prokurori i shtetit i paraqet gjyqtarit të procedurës paraprake kërkesën për caktimin e paraburgimit<sup>10</sup>.

Në mënyrë që prokurorët të hartojnë kërkesa të arsyetuara mirë për paraburgim, ata brenda kësaj periudhe prej 24 orëve duhet të pranojnë sa më shpejt kallëzimet penale të policisë të cilat duhet të jenë sa më të kompletuara në mënyrë që kërkesat e prokurorit për caktimin e masës për prezencën e të dyshuarit të jenë sa më të suksesshme.

BIRN dhe I/KS, gjatë procesit të monitorimit, kanë hasur në disa raste kur policia ka dorëzuar kallëzime penale të vonuara. Ankesat e prokurorëve sa i përket mos arsyetimit të mirë të kërkesave për caktimin e masës së paraburgimit qëndrojnë në vonesat e kallëzimeve penale të policisë. Ata, thonë se shpeshherë pranojnë kallëzime penale 22 apo 23 orë pas arrestimit të të dyshuarve, vetëm një apo dy orë para skadimit të afatit ligjor prej 24 orësh, të cilat madje thonë se shpeshherë nuk janë të kompletuara me prova përcjellëse dhe adekuate në kallëzimin penal. Afati i shkurtër për dorëzimin e kërkesave për caktimin e masës së paraburgimit thonë se ndikon drejtpërdrejt edhe në kualitetin e arsyetimeve në kërkesat e tyre, që në të shumtën e rasteve janë shabllone dhe të

<sup>8</sup> Shih faqet 8, 9 dhe 10 të këtij raporti.

<sup>9</sup> Shih neni 70 par.4

<sup>10</sup> Po aty neni 164 par.7 i KPRK-së.

paarsyetuara si duhet.

Pos rasteve kur policia dorëzon kallëzime penale pak orë para skadimit të afatit, BIRN dhe I/KS kanë gjetur së paku 9 raste kur policia ka dorëzuar kallëzimet penale pas kalimit të afatit prej 24 orësh.

Në një rast në Prizren policia kishte ndaluar një person nën dyshimin për kryerje të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 374 par.1, ku i dyshuari ishte kapur me tri armë, njëra prej tyre armë e gjatë “AK 47” e cila i ishte gjetur në veturën e tij dhe dy revole të citat i janë gjetur në shtëpi. Arrestimi ishte bërë më 04.11.2015 në ora 06:30 minuta, ndërsa kallëzimi penal në zyrën e prokurorit kishte shkuar më datë 05.11.2015 në ora 10:15 minuta, rreth 28 orë pas arrestimit. Prokurori, duke u gjendur para një situatë të tillë, për shkak të kalimit të afatit prej 24 orësh, është detyruar që të dyshuarin ta lirojë në procedurë të rregullt nga pamundësia që të bëjë propozim për shqiptimin e ndonjë mase për sigurinë e prezencës së tij, ngase për shkak të kalimit të afatit, gjykata do ta refuzonte një kërkesë të tillë. Lënda mbante numrin PP.nr.305/15.

“Detyrim ligjor i prokurorit është të ndërmarrë masa edhe kundër policisë, sepse kur dështon prokurori në paraqitjen e kërkesës dhe arsyetimit për caktimin e masës së paraburgimit, policët duhet të thirren në përgjegjësi, duhet të mirren masa ndaj tyre”.  
Besim Kelmendi – Prokuror në Prokurorinë e Shtetit

Poashtu në Prizren, në rastin tjetër me numër të lëndës PP.nr.306/15, nën dyshimin për kryerje të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 374 par.1 në rrethana gati të ngjashme me rastin e lartëcekur, kallëzimi penal i policisë i është dorëzuar prokurorisë pas kalimit të afatit prej 24 orësh. Edhe në këtë rast, prokurori në pamundësi të propozimit për ndonjë masë, është detyruar që të dyshuarin ta lirojë në procedurë të rregullt.

Vonesat e këtyre rasteve janë paraqitur nga zyrtarë të ndryshëm policorë ndaj të cilëve nuk është inicuar asnjë procedurë penale apo disiplinore duke lënë hapësirë që raste të ngjashme të ndodhin edhe në të ardhmen me arsyetimin se afati për dorëzimin e kallëzimit penal është i shkurtër dhe se në praktikë mund të ndodhin raste të ngjashme.

Në Gjakovë në rastin PP- 1651/15 të datës 04.12.2015, i dyshuari është ndaluar për shkak të dyshimit se ka kryer dy vepra penale “Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare” nga neni 410 dhe vepra penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 273 i KPRK-së. Për shkak të dorëzimit me vonesë të kallëzimit penal nga policia, për çka edhe kishte kaluar afati ligjor prej 24 orësh, prokurori i çështjes është detyruar që të dyshuarin për kryerje të dy veprave të rënda penale ta lirojë në procedurë të rregullt.

Ndërsa për dallim nga rastet e Prizrenit dhe të Gjakovës, në Prishtinë, në së paku tre raste

Raporti ka hasur në kërkesa të prokurorëve të dorëzuara në gjykatë për caktimin e masës së paraburgimit pas kalimit të afatit 24 orësh, të cilat gjyqtari i procedurës paraprake i ka refuzuar për shkak të kalimit të afatit ligjor. Të tri rastet kanë të bëjnë me arrestimet gjatë protestave të datës 27 janar 2015, për shkak të dyshimit në kryerjen e veprës penale



“Detyrim ligjor i prokurorit është të ndërmarrë masa edhe kundër policisë, sepse kur dështon prokurori në paraqitjen e kërkesës dhe arsyetimit për caktimin e masës së paraburgimit, policët duhet të thirren në përgjegjësi, duhet të mirren masa ndaj tyre”  
**BESIM KELMENDI**  
– PROKUROR NË PROKURORINË E SHTETIT

“Pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizmi” nga neni 412 par.4 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Rasti i parë, ka të bëjë me kërkesën e prokurorisë PP.II. nr. 600/15 të datës 28.01.2015 me të cilën prokuroria kërkoi caktimin e paraburgimit për 7 të dyshuar. Gjykatësi i procedurës paraprake Isuf Makolli e refuzoi këtë kërkesë me aktvendimin PPR. Nr. 81/15 pasi që e konsideroi kërkesën e prokurorisë si të paraqitur jashtë afatit të paraparë me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Rasti i dytë, ka të bëjë me kërkesën e prokurorisë PP.II. nr. 597/15 të datës 28.01.2015 me të cilën prokuroria kërkoi caktimin e paraburgimit për 8 të dyshuar. Edhe në këtë rast gjykatësja e procedurës paraprake Lumnije Krasniqi e refuzoi kërkesën e prokurorisë me aktvendimin PPR. Nr. 78/15 pasi që e konsideroi si të paraqitur jashtë afatit të paraparë me Kodin e Procedurës Penale.

Dhe rasti i tretë ka të bëjë me kërkesën e prokurorisë PP.II. nr. 606/15 të datës 28.01.2015 me të cilën prokuroria kërkoi caktimin e paraburgimit për 9 të dyshuar. Edhe për këtë rast, gjykatësja e procedurës paraprake Naime Krasniqi mori aktvendim refuzues me numër të lëndës PPR. Nr. 105/15 pasi që kërkesa konsiderohej e paraqitur jashtë afatit të paraparë me KPPRK-në.

Poashtu në Prishtinë, Raporti ka hasur në një rast në procedurë penale për të mitur. Afati i prokurorit për paraqitjen e kërkesës për caktimin e masës për të mitur është 12 orë<sup>11</sup>, ndërsa në këtë rast prokuroria Ferdane Sylejmani paraqiti kërkesën pas këtij afati dhe në pamundësi të shqiptimit të masës për sigurinë e prezencës së të miturit në procedurë për shkak të kalimit të afatit ligjor, i mituri me aktvendimin e gjyqtarës Lumnije Krasniqi PPRM. nr. 74/15 u lirua në procedurë të rregullt. Vepra penale e dyshuar ishte “lëndim i rëndë trupor” nga neni 189 par. 5 lidhur me par. 1, e lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Në rastin tjetër në Gjykatën Themelore të Prishtinës, me numër të lëndës PKR.nr.169/16, ka qenë një i pandehur i dyshuar për veprën penale Zjarrvënje nga neni 334 par.2 të KPRK-së. Si rrjedhojë e vonesës, kërkesa për caktimin e paraburgimit nga prokuroria është dashur të refuzohet nga gjykatësi Faik Hoxha.

Në Gjykatën Themelore të Gjakovës në rastin me numër të lëndës PP/I nr.62/16 për veprën penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 275 par.1 dhe 3, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës, Policia ndaj të dyshuarve L. U., T. F. dhe K. R. ka paraqitur me vonesë kallëzimin penal në Prokurorinë Themelore të Gjakovës, në Departamentin për Krime të Rënda, konkretisht te prokurori Agron Matjani. Si rezultat i kësaj prokuroria ka dështuar të bëjë kërkesë për shqiptimin e masës.

Dorëzimi me vonesë dhe i pakompletuar i kallëzimeve penale nga ana e policisë, ndikon drejtpërdrejt në performancën e prokurorëve, duke mos u lënë atyre kohë të mjaftueshme për të hartuar kërkesa profesionale për shqiptimin e masës së paraburgimit, të mbështetura në argumente relevante. Prokurorët, zakonisht në raste të tilla kur

---

<sup>11</sup> Shih Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 65 par. 2

pranojnë kallëzime të vonuara parashtrajnë kërkesa shabllone duke u thirrur në dispozita procedurale shabllone, pa argumentuar fakte nga rastet konkrete, gjë që e gjithë barra bie në gjyqtarin e procedurës paraprake për të argumentuar kërkesën e prokurorit për caktimin e masës së paraburgimit. Në praktikë nuk janë të rralla rastet kur gjykata e shkallës së dytë këto vendime i prish në mungesë të argumentimit të mirë të rastit konkret.

“Sa i përket paraburgimit, shqetësimi më i madh është koha – afati 24 orësh, sidomos te veprat penale ku ka shumë të pandehur ku duhet të merren disa veprime, është shumë afat i shkurtër. Problemi serioz që kemi hasur është vazhdimi i paraburgimit, aty duhet arsyetuar mirë dyshimi pse i pandehuri duhet të qëndrojë në paraburgim”. Admir Shala – Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Prizren

Raporti konsideron se policia duhet të kujdeset dhe ta trajtojë me prioritet dorëzimin e kallëzimeve penale në prokurori në kohë sa më të shkurtër, për shkak se mos dorëzimet në kohë dhe vonesat e paarsyeshme krijojnë zinxhirë problemesh nga policia në prokurori e deri në gjykatë, duke bërë që kryes të veprave penale të rënda të lirohen në procedurë të rregullt pa u shqiptuar ndonjë masë për sigurinë e prezencës së tyre në procedurë. Kjo krijon rrezik të madh që kryes të fillë të arratisen dhe të mos gjykohen fare, duke treguar edhe jo profesionalizëm dhe mos efikasitet të sistemit gjyqësor në kapjen dhe dënimet e kryesve të veprave penale.

## B) Dështimi i Arsyetimit të vendimeve për paraburgim

Sipas Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale dhe se çdo person që arrestohet dhe burgoset në kundërshtim me argumentimin e mirë për qëndrim në paraburgim ka të drejtën në dëmshpërblim<sup>12</sup>. E gjithë barra për arsyeshmërinë e qëndrimit të një personi në paraburgim bie mbi prokurorin i cili duhet të argumentojë dyshimin e bazuar para gjykatës të mbështetur në prova dhe fakte që një person ka kryer veprën penale për të cilën dyshohet dhe se i njëjti duhet të qëndrojë në paraburgim.

Procedura penale fillohet vetëm me vendim të prokurorit të shtetit kur ekziston ky dyshim i bazuar se është kryer vepër penale<sup>13</sup>. Raporti ka vërejtur në praktikë disa raste kur prokurorët nuk kanë arritur të dëshmojnë me prova të artikuleshme “dyshimin e bazuar” para gjykatësit të procedurës paraprake se i dyshuari ka kryer veprën penale. Në shumë raste prokurorët paraqesin propozimet e tyre në shabllone, vetëm duke u mbështetur në ekzistencën e tri kushteve të parapara në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për caktimin e masës së paraburgimit nga neni 187 par.1 të KPPRK-së, ndërsa kanë dështuar të arsyetojnë me saktësi provat që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me rastin konkret.

Raporti, gjatë monitorimit të rasteve të seancave të procedurës paraprake për caktimin e masës së paraburgimit ka vërejtur që propozimet e prokurorëve edhe pse të paarsyetuara si duhet nuk kundërshtohen dhe në të shumtën e rasteve ato aprovohen nga gjykatësit e procedurës paraprake. Nuk janë të rralla rastet kur këta të fundit kanë dështuar në arsyetimet e tyre për caktimin e masës së paraburgimit dhe gjykata e shkallës së dytë këto

<sup>12</sup> Neni 5 par.1 dhe 3 KEDNj.

<sup>13</sup> Shih neni 6 par.2 i KPPRK-së

vendime të paarsyetuara i ka prishur.

Rastet në vijim janë të gjeturat e Raportit gjatë monitorimit në teren, të cilat shërbejnë si shembuj të vendimeve të pa arsyetuara si duhet nga prokurorët dhe gjykatësit e procedurës paraprake:

Në një rast në [Gjykatën Themelore të Prishtinës](#), me numër të lëndës PKR.nr.263/2015 ku i dyshuar ishte kryetari i Gjykatës së Apelit, Sali Mekaj, që po hetohej nga Prokuroria Speciale e Kosovës nën dyshimin për kryerje të veprave penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 i KPRK-së dhe “Ushtrimi i ndikimit” nga neni 431 i KPRK-së, fillimisht prokurorja e rastit Drita Hoxha kërkoi që ndaj tij të caktohet masa e paraburgimit, mirëpo në mungesë të argumentimit të duhur, gjykatata e shkallës së parë, konkretisht gjykatësi Vehbi Kashtanjeva vendosi që ndaj tij të caktohet masa e arrestit shtëpiak.

“Ne nuk kemi arritur që t’i arsyetojmë vendimet në atë nivel që konsiderojmë që janë të domosdoshme, për shkak se vetëm gjatë vitit 2016 i kemi shqyrtuar 2,190 lëndë dhe ekziston mundësia se jemi shabllonizuar. Me rritjen e numrit të gjyqtarëve mendoj që do të arrijmë edhe këtë ta përmirësojmë”.

Hasan Shala – Kryetar i Gjykatës së Apelit

Ndërsa pas ankesës së mbrojtjes në Gjykatën e Apelit, kolegji i kësaj gjykate vendimin me të cilin i është caktuar masa e arrestit shtëpiak të dyshuarit e quajti “për keqardhje” dhe atë masë e zëvendësoi me masën e ndalimit për t’iu ofruar vendit apo personit të caktuar në kohëzgjatje prej dy muajsh. Në aktvendimin e Gjykatës së Apelit me numër të lëndës PN.nr.1431/2015 ndër të tjera thuhet se gjykatata e cakton arrestin shtëpiak kur prokurori i shtetit kërkesën e vet e ka arsyetuar dhe e ka mbështetur në prova të pakontestueshme.

“Propozimi i prokurorit për paraburgim sa i përket bazave ligjore nga pika 1.2.1. dhe 1.2.3 të nenit 187 të KPPRK-së, nuk përfshinte asnjë provë që ligji kërkon përpos një përshkrimi fjalë për fjalë të normës ligjore. Është për keqardhje që gjykatat propozimet e tilla të paarsyetuara fare, si zakonisht pa asnjë vlerësim kritik i akcepton”.

Po ashtu në aktvendimin e Gjykatës së Apelit thuhet se gjykatata e shkallës së parë pos që vendimin nuk e mbështet në prova, madje bën edhe konstatime paushalle.

“Jo vetëm që janë të pa mbështetura në prova fare, por janë edhe konstatime paushalle të gjykatës së shkallës së parë kur thekson se “të pandehurit nuk do të hezitojnë që të kryejnë vepra tjera penale!!!” dmth sipas këtij konstatimi, ata nëse ndodhen në liri do t’i përsërisin veprat tjera penale!?!??. Ky konstatim është puro arbitrar, ngase para së gjithash për të pandehurin e parë bëhet fjalë për një gjyqtar që asnjëherë në jetën e gjertanishme të jetës së tij nuk ka ardhë në konflikt me ligjin, është njeri familjar, i moshuar dhe gjithashtu nuk rezulton se edhe e pandehura e dytë ndonjëherë ka qenë e skeduar penalisht”.

Rasti konkret është shembulli tipik i prezantimit të gjendjes reale në teren ku fillimisht prokuroria nuk arrin ta argumentojë dhe arsyetojë kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit, pastaj edhe gjykatata e vazhdon këtë trend, duke mos e arsyetuar si duhet edhe masën tjetër, atë të arrestit shtëpiak.

Rast tjetër në gjykatën e Prishtinës, i cili dëshmon dështimin e prokurorisë për të arsyetuar propozimin për caktimin e paraburgimit, është rasti i të akuzuarit për “Vrasje në tentativë”, i cili mban numrin e lëndës PKR.238/15. Në këtë rast gjatë shqyrtimit kryesor, pas kërkesës së avokatit mbrojtës për lirimin nga paraburgimi të të mbrojturit të tij, prokurori i çështjes Abdurrahim Islami e kundërshtoi këtë kërkesë të mbrojtjes me një arsyetim të pabazuar në asnjë provë, kundërshtimi i prokurorit ishte:

“Nuk janë pjekur kushtet për t’u liruuar i akuzuari nga paraburgimi, e kundërshtoj këtë masë”.

Prokurori, duke mos dhënë asnjë provë bindëse që i akuzuari edhe më tutje duhet të qëndrojë në paraburgim dhe duke mos dhënë asnjë sqarim konkret, bëri që gjykata ta aprovojë kërkesën e avokatit dhe të akuzuarit ia zbuti masën për sigurimin e prezencës së tij në procedurë.

“Ne mund ta hedhim fajin te policia apo prokuroria, mirëpo në aspektin legjislativ gjyqtari është fajtori kryesor në këtë çështje, sepse ai është për të nxjerrë vendimin dhe ai është për të vlerësuar kërkesën, çfarëdoqoftë ajo. Nuk mundemi t’ia hedhim fajin as prokurorisë, as policisë, faji është tek ne”.

Ali Kutllovci – Kryetar i Gjykatës Themelore në Mitrovicë

Në Gjykatën Themelore të Prizrenit, në rastin me numër të lëndës PP.nr.249/15, ku ishin gjashtë të dyshuar, në mesin e tyre drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prizren, Nexhat Çoçaj dhe pesë zyrtarë të kësaj drejtorie, nën dyshimin për kryerje të veprave penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 dhe vepra penale “cenimi të drejtave të punësimit dhe të papunësisë” nga neni 222 i KPRK-së, fillimisht prokurori i çështjes Sefer Morina, para gjykatësit të procedurës paraprake kërkoi masën e paraburgimit për të gjithë të pandehurit. Ai tha se dy prej tyre njihen edhe si recidivistë për organet e drejtësisë, edhe pse në realitet asnjëri nga ta nuk ishte ansjherë i dënuar për asnjë vepër penale. Gjykatësi i procedurës paraprake, Xheladin Osmani, aprovoi kërkesën e prokurorit për caktimin e masës së paraburgimit për njërin nga të dyshuarit, ndërsa pesë të tjerëve u caktoi masën e arrestit shtëpiak. Pas ankesave të mbrojtjes, Gjykata e Apelit mori aktvendim me të cilin ndërpreu masën e paraburgim si dhe masat e arrestit shtëpiak, duke i zëvendësuar për gjashtë të pandehurit me masën e ndalimit për t’iu ofruar vendit apo personit të caktuar. Në aktvendimin e Gjykatës së Apelit, ndër të tjera thuhet:

“Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë cakton masën e paraburgimit apo të arrestit shtëpiak kur prokurori kërkesën e vet e arsyeton dhe e mbështet në prova të pakontestueshme, e këtë kërkesë ligjore prokurori nuk e ka mbështetur fare dhe përkritazi me bazën ligjore “frikën për arratisje dhe për përsëritje të veprës penale” është mjaftuar me një arsyetim klishe e të cilin e ka akceptuar edhe gjykata e shkallës së parë, e cila jo vetëm që nuk ka ofruar prova të qarta dhe konkrete se në çka e mbështet pretendimin se të pandehurit mund të arratisen, por s’ka ofruar as prova të tërthorta (indicie) për t’i mbështetur pretendimet e veta për këtë masë. Gjykata e shkallës së parë vetëm ka bërë parafrazim të dispozitave ligjore pa u mbështetur në asnjë provë konkrete”.

Poashtu, në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në rastin me numër të lëndës PP/I. Nr.



“Nuk janë pjekur kushtet për tu liruuar i akuzuari nga paraburgimi, e kundërshtoj këtë masë”  
**ABDURRAHIM ISLAMI, PROKUROR**



78/2015 për shkak të dyshimit në kryerjen e veprës penale “vjedhje e rëndë” nga neni 327 par.2 pika 2.2 të KPRK-së, prokurori bëri kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit për dy të dyshuarit (S.M. dhe F.A.). Mirëpo në mungesë të arsyetimit, Gjykatësi i procedurës paraprake Vehbi Kashtanjeva me aktvendimin PPR.KR. nr. 24/15 e ka refuzuar këtë kërkesë të prokurorisë për caktimin e paraburgimit duke e cilësuar si të pa bazuar, dhe i caktoi masën e arrestit shtëpiak, pasi që edhe me masën e arrestit shtëpiak do të arrihej siguri i të pandehurve në procedurë.

**Në Gjykatën Themelore të Gjakovës**, në rastin me numër të lëndës PPr.Kr.nr. 71/16, ndaj të pandehurit E.N. për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 273 par.2 të KPRK-së, gjykata e shkallës së dytë ka prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë të gjyqtarit të procedurës paraprake Nikollë Komani, me të cilin të pandehurit i ishte caktuar një muaj paraburgim, duke e zëvendësuar me masën e arrestit shtëpiak. Apeli me vendimin PN.1.nr.984/16 konstatoi se vendimi ishte i paarsyetuar dhe jo i duhur për rastin konkret.

“Gjyqtarët duhet të jenë më vendimmarrës sepse nëse prokurorët nuk i kanë arsyetuar mire kërkesat për paraburgim, atëherë të njëjtat nuk do të kalojnë dhe kjo për bindjen time do të shërbente për disiplinimin apo aftësimin më të madh profesional edhe të prokurorëve. Nëse dështojnë në një rast, në rastin tjetër do të jenë më të vëmendshëm dhe do t'i kushtojnë më shumë rëndësi arsyetimit. Gjyqtarët duhet t'i sfidojnë presionet mediatike, pra nuk duhet të gjykojnë se çka mendon opinion publik, por duhet të gjykojnë çka thonë faktet dhe provat”.

Bashkim Hyseni – Kryetar i Gjykatës Themelore në Ferizaj

**Në Gjykatën Themelore të Prishtinës**, në lëndën me numër PP/II.nr.3784/16 ndaj J.A. për shkak të veprës penale rrezikimi i komunikacionit rrugor, prokurorja Shemsije Asllani me dorëzimin e aktakuzës, kërkoi edhe vazhdimin e paraburgimit. Ajo në kërkesën e saj për caktimin e paraburgimit kërkoi masën e paraburgimit konform nenit 187 par. 1, 2 dhe 3 për shkak të “peshës së veprës penale”, pasi që ka humbur jetën një person në aksident. Pika 3 të cilën e përmend prokurorja në Kodin e Procedurës Penale parasheh rrezikun se i pandehuri mund ta përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryejë. Pra, qenësore e kësaj pike është rreziku i përsëritjes së veprës penale. Në rastin konkret, përveç që kërkesa e prokurorit nuk jep asnjë rrethanë apo karakteristikë të kryesit, siç janë veprat e mëparshme të kësaj natyre, dënimet për shpejtësi në komunikacion, precedentët e mëparshëm penalë, gjithashtu është krejt e pakuptueshme se një person mund të përsërisë veprën e “rrezikimit të trafikut” ose shkaktimin e aksidenteve me fatalitet pasi që elementi kryesor të këto lloje të veprave penale është mungesa e dashjes dhe si e tillë parimisht e përjashton rrezikun e përsëritjes. Gjyqtari Kujtim Krasniqi, në këtë rast ka refuzuar caktimin e paraburgimit dhe ka caktuar masën e arrestit shtëpiak.

Një rast tjetër në **Gjykatën Themelore të Prizrenit**, dega në Suharekë, me numër të lëndës P.nr. 742/12 dëshmon faktin që ka prokurorë të cilët pikërisht në rastet kur ata duhet të kërkojnë caktimin e masës së paraburgimit nuk deklarohen fare. Rasti ka të bëjë me veprën penale “vjedhje e rëndë” nga neni 253 par. 1 i KPRK-së. Pasi që i akuzuari nuk i ishte përgjigjur ftesës për gjykim si njëra nga masat për sigurimin e prezencës së të pandehurit,

gjykatësi i çështjes kërkoi mendimin e prokurorit për caktimin e masës së paraburgimit në mënyrë që të sigurohet prezenca e të pandehurit në procedurë, mirëpo përgjigja e prokurorit ishte:

“Unë nuk kam çka të them lidhur me paraburgimin. Unë vetëm mund të marr pjesë dhe nuk deklarohej”. Ndërsa reagimi i gjykatësit ishte: “Për sy të zi nuk ju kemi thirrë këtu, prokuror”.

Shembujt e mësipërm, janë vetëm disa nga rastet e shpeshta në praktikë të kërkesave për caktimin e masës së paraburgimit, të cilat dëshmojnë se prokurorët shpeshherë vetëm parafrzojnë dispozitat ligjore në mënyrë shabllone pa ofruar argumente konkrete për qëndrimin e të pandehurit në paraburgim dhe pa i ndërlidhur fare propozimet e tyre me rrethanat e secilit rast konkret.

Siç u dëshmua nga shembujt, praktikë të njëjtë të mos arsyetimit adekuat të vendimeve për caktimin e masës së paraburgimit kanë ndjekur edhe gjykatat e shkallës së parë.

BIRN dhe I/KS kanë vërejtur që prokurorët por edhe gjykatësit me rastin e kërkesës dhe caktimit të masës së paraburgimit nuk vlerësojnë fare shpenzimet e buxhetit shtetëror për qëndrimin e një të pandehuri në paraburgim, ku një ditë qëndrimi në paraburgim për një person vlerësohet t'i kushtojë buxhetit hiç më pak se 29- 30 euro.<sup>14</sup>

Raporti vlerëson se me rastin e kërkesës për caktimin e paraburgimit prokurorët, duhet të bëjnë më shumë përpjekje për të arsyetuar kërkesat e tyre me arsye adekuate për rastet konkrete, vetëm atëherë kur kjo masë është e domosdoshme. Poashtu, gjykatësit e procedurës paraprake duhet t'i kundërshtojnë kërkesat e prokurorisë atëherë kur ato nuk janë të argumentuara mirë, e kurrësi që vet të marrin vendime të paarsyetuara për caktimin e masës së paraburgimit.

“Të aplikohen edhe masa të tjera të cilat i parasheh kodi, sepse kemi masa që nuk janë aplikuar kurrë”. Afërdita Bytyqi – Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë

Është shqetësues fakti i aplikimit të shpeshtë të masës së paraburgimit në praktikë dhe lënia anash e masave tjera për sigurinë e prezencës së të pandehurit në procedurë. Gjykatat duhet të aplikojnë më shpesh masën e “dorëzaniës” dhe në vend të masës së paraburgimit, në të shumtën e rasteve të shqiptohet dorëzania si masë alternative për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë, ngase me këtë masë do të evitoheshin shpenzimet dhe do të evitoheshin gabimet për heqje të lirisë personave që në fund potencialisht mund të rezultojnë të pafajshëm. Me këtë masë edhe nëse i pandehuri do të ikte, vlera e dhënë si dorëzani ashtu siç parashihet me ligj, me aktvendim të gjykatës do të derdhej në fondin për kompensimin e viktimave dhe në një mënyrë kryesit e veprave penale do të merrnin dënimin për veprën penale të kryer.



“Të aplikohen edhe masa të tjera të cilat i parasheh kodi, sepse kemi masa që nuk janë aplikuar kurrë”.  
AFËRDITA BYTYQI,  
KRYETARE  
E GJYKATËS  
THEMELORE NË  
PRISHTINË

<sup>14</sup> Raporti i Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, QKRMT 2014.Fq 55.

## C) Paraburgimet e gjata në pritje të gjykimit

Raporti, gjatë monitorimit të seancave me paraburgim, ka vërejtur se sa i përket kohëzgjatjes së qëndrimit të të dyshuarve në paraburgim në praktikë ka raste të shkeljes së Konventave europiane, e poashtu të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut përcakton qartë se heqja e lirisë duhet të trajtohet me shpejtësi: “Çdo heqje lirie, e sidomos kohëzgjatja e paraburgimit në procedurë penale, duhet zvogëluar në kohën sa më të shkurtër të mundshme”.<sup>15</sup>

Edhe Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, në nenin 5, e ka të përcaktuar parimin për “Gjykim të drejtë, të paanshëm dhe në afat të arsyeshëm”. Edhe pse konventa nuk përcakton saktë kohën sa një i pandehur duhet të qëndrojë në paraburgim. Afati kohor sa i përket qëndrimit në paraburgim para ngritjes së aktakuzës është specifikuar në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, sipas të cilit para ngritjes së aktakuzës për vepra të rënda penale paraburgimi mund të zgjasë më shumti deri në një maksimum të përgjithshëm të paraburgimit prej tetëmbëdhjetë (18) muajsh.<sup>16</sup>

Ajo që më shumë është hasur në teren është koha e gjatë e qëndrimit në paraburgim të pandehurve pas ngritjes së aktakuzës. Edhe pse askund në kod nuk është precizuar koha e saktë se sa një i akuzuar mund të qëndrojë në paraburgim pas ngritjes së aktakuzës, megjithatë është përcaktuar saktë sa duhet të jetë koha për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor. Sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, nëse shqyrtimi gjyqësor mbahet para gjyqtarit të vetëm gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundohej brenda nëntëdhjetë (90) ditësh, ndërsa nëse shqyrtimi gjyqësor mbahet para trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundohej brenda njëqindnjëzet (120) ditëve, me mundësi vazhdimi edhe për tridhjetë (30) ditë të tjera, në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme të numrit të madh të provave dhe dëshmitarëve.<sup>17</sup>

Pra, maksimumi i kohës për përfundimin e një shqyrtimi gjyqësor në rastet e rënda kur ai udhëhiqet nga trupi gjykues, me gjithë mundësitë e vazhdimit për shkak të rasteve të ndërlikuara me numër të madh të provave dhe dëshmitarëve, ligji parasheh maksimumin e kohëzgjatjes deri në pesë muaj (120 plus 30 ditë të tjera), ndërsa në praktikë janë hasur raste të qëndrimit të të pandehurve në paraburgim deri në 6 vite pa u marrë asnjë aktgjykim për rastin.

Rastet në vijim shërbejnë si shembuj të rasteve kur të pandehurit mbahen në paraburgim për periudhë të gjatë kohore dhe shqyrtimet gjyqësore zgjasin me vite të tëra.

Në rastin PKR.nr.33/2013 ku dy të pandehur akuzoheshin për kryerje të veprës penale “Vrasje e rëndë”, njëri nga të pandehurit, Gëzim Ratkoceri, qëndroi nën masën e paraburgimit pa u gjykuar nga data 30.04.2009 deri më 07.07.2015, ndërsa Osman Spahiu qëndroi nën masën e paraburgimit nga data 10.05.2009 deri më 07.07.2015 kur edhe janë gjykuar dhe shpallur fajtorë në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Pavarësisht veprës penale të kryer, qëndrimi në paraburgim prej 6 vite e tre muaj përkatësisht 6 vite e dy

<sup>15</sup> Shih neni 5 par.3 i KEDNJ-së.

<sup>16</sup> Neni 190 par. 2 (1, 2) par. 3 dhe 4 të KPPRK-së.

<sup>17</sup> Neni 314 par. 1, 2,3 të KPPRK-së.

muaj është stërzgjatje e qëndrimit nën këtë masë, e cila tejkalon çdo kufi për gjykim të drejtë dhe në afat të arsyeshëm të paraparë si në konventat europiane ashtu edhe në ligjet vendore. Prokurore e këtij rasti është Fikrije Fejzullahu, ndërsa trupi gjykues ishte i përbërë nga Florent Latifaj, kryetar i trupit gjykues dhe dy anëtarët, Afërdita Bytyqi dhe Hajrije Shala.

Në një rast tjetër në Gjakovë, i akuzuari me inicialet N.Sh. akuzohet për vepër penale të vrasjes nga neni 178 i KPRK-së, si dhe vepra penale e mbajtjes në pronësi, kontroll, ose posedim i paautorizuar i armëve, nga neni 374 par.1 i KPRK-së. Ai, gjendet në paraburgim nga data 11.03.2013 dhe ende kjo lëndë gjendet në fazën e shqyrtimit kryesor, përderisa të akuzuarit po i bëhen gati katër vite qëndrim në paraburgim ende pa u marrë vendimi për lëndën e tij. Rasti mban numrin e lëndës P.nr. 250/13.<sup>18</sup>

Po ashtu në Gjykatën Themelore të Gjakovës në lëndën me numër PKR.nr. 61/14 i akuzuari Fuat Gjevukaj vazhdon të jetë në paraburgim nga data 09.05.2014, lëndë kjo të cilën është duke e gjykuar gjykatësi Gëzim Pozhegu.

Në Gjykatën Themelore të Prizrenit, në rastin me numër të lëndës P.nr.124/12 për shkak të veprës penale "Rrëmbimi i personit" nga neni 159 i KPRK-së, dy të akuzuar në këtë rast B.K. dhe S.Sh. u mbajtën në paraburgim nga data 30.09.2011 deri më 31.10.2013, nga dy vite e një muaj për secilin. Nga 31 tetori i vitit 2013 rreth dy vite e gjysmë nga lirimi i të akuzuarve nga paraburgimi, për këtë rast nuk u caktuan seanca gjyqësore, ndërsa tani lënda është ende në procedurën e provave. Ky rast dëshmon për zvarritjen dhe stërzgjatjen e procedurave gjyqësore duke tejkaluar çdo afat ligjor.

Duke u bazuar në faktin se paraburgimi duhet të reduktohet në kohën sa më të shkurtër të mundshme, kur i pandehuri mbahet në paraburgim, të gjitha organet që marrin pjesë në procedurën penale dhe organet që ofrojnë ndihmën juridike detyrohen të veprojnë me ngut të posaçme.<sup>19</sup> Raporti konsideron se gjykatat duhet të kenë më shumë kujdes dhe të trajtohen me prioritet lëndët në të cilat ka të akuzuar që ndodhen në paraburgim. Gjykatat në Kosovë duhet t'i përbahen më me kujdes zbatimit të dipozitive ligjore të përcaktuara në kodin e procedurës penale të cilat rregullojnë kohëzgjatjen e paraburgimit dhe kohëzgjatjen e fillimit dhe përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.

## **D) Mos respektimi i afateve për caktimin e shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimi i dytë**

Me ndryshimet në kodin e ri të procedurës penale, janë paraparë edhe afatet kohore brenda të cilave duhet të mbahen seancat gjyqësore. Pas ngritjes së aktakuzës, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet të caktojë menjëherë shqyrtimin fillestar i cili duhet të mbahet brenda 30 ditëve nëse i pandehuri gjendet në liri, ndërsa nëse i pandehuri është në mbajtje në paraburgim, shqyrtimi fillestar mbahet në mundësinë e parë, jo më vonë se 15 ditë pas ngritjes së aktakuzës.<sup>20</sup>

Pas shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton

<sup>18</sup> Këtë rast e ka gjykuar ish gjykatësi, tani i dalur në pension Hilmi Hoxha, pas pensionimit të tij rastin e ka marrë gjykatësi Gëzim Pozhegu me anëtarët e trupit gjykues Manduhije Sylja dhe Ilir Rashkaj  
<sup>19</sup> Shih neni 185 par.2 i KPRK-së.

<sup>20</sup> Shih neni 242 par.4 dhe 5 të KPPRK-së.

shqyrtimin e dytë jo më herët se 30 ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se 40 ditë pas shqyrtimit fillestar. Në të kundërtën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se 30 ditë nga shqyrtimi fillestar.<sup>21</sup>

Edhe përkundër faktit se Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës parasheh afate strikte sa i përket caktimit të këtyre seancave gjyqësore, Raporti ka hasur në raste kur këto afate nuk janë respektuar nga gjyqtarët e procedurës paraprake.

Rast tipik i mosrespektimit të afateve është rasti në të cilin të akuzuar janë Zeqirja Qazimi dhe të tjerët, të akuzuar për kryerje të veprave penale të terrorizmit, në lëndën me numër PKRR. 54/15. Të akuzuarit qëndronin në masën e paraburgimit dhe përkundër faktit që Kodi i Procedurës Penale parasheh që kur të akuzuarit janë në masën e paraburgimit, pas ngritjes së aktakuzës, ata duhet që brenda 15 ditësh të dalin para gjyqtarit në seancën fillestare. Kjo në këtë rast nuk ndodhi dhe afati u tejkalua për afër gjashtë muaj. Aktakuza në këtë rast ishte ngritur më 02.03.2015 ndërsa seanca fillestare u mbajt më 03.09.2015<sup>22</sup>.

Poashtu, në rastin e ish- Inspektorëve të Komunës së Prishtinës me numër të lëndës PKR. nr.341/15, ku Prokuroria Speciale e Kosovës i ngarkonte dhjetë ish-zyrtarët e Komunës së Prishtinës për pjesëmarrje ose organizim të grupit kriminal në lidhje me keqpërdorim të detyrës zyrtare ose autorizimit, aktakuza ishte ngritur në qershor të vitit 2015, ndërsa seanca fillestare ishte mbajtur më 25 gusht 2015, duke mos respektuar afatin e paraparë në nenin 242 par.4 të KPPRK-së.

Si rast i tejkalimit dhe mos respektimit të afateve për caktimin e shqyrtimit të dytë pas seancës fillestare është edhe rasti PKR.392/15 në të cilin është i akuzuar Sllobodan Gavriq, i cili akuzohej për veprën penale të përgatitjes së veprave terroriste, ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës. Përkundër asaj se Kodi i Procedurës Penale parasheh që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin e dytë jo më herët se 30 ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se 40 ditë pas shqyrtimit fillestar, në këtë rast gjykata ka caktuar seancën fillestare me datën 30.07.2015 ndërsa seancën e shqyrtimit të dytë e ka caktuar më datën 21.09.2015 ku edhe për 13 ditë të tjera e ka tejkaluar afatin 40 ditor<sup>23</sup>.

"Le ta harrojë dikush që të kërkojë përgjegjësi prej neve lidhur me afatet në Gjykatën e Mitrovicës kur dihet kaosi që është atje ku gjysma e stafit nuk është, kur kemi gjyqtar që paguhet e nuk del në punë, ndërsa pjesa tjetër e stafit e mbulon punën e tij. Kur një gjyqtar i krimeve të rënda i ka 900 lëndë, çka të bëjë ai më parë?!".

Ali Kufllavci – Kryetar i Gjykatës Themelore në Mitrovicë

Në seancën gjyqësore me numër të lëndës PKR.nr.14/16 në Gjykatën Themelore të Prishtinës, të mbajtur më datë 09 shtator 2016, për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPPRK-së, aktakuza ndaj të pandehurit

21 Shih neni 245 par.5 i KPPRK-së.

22 Kryetari i trupit gjykues Musa Kongjeli, prokurori Suad Kuraja.

23 Kryetare e trupit gjykues Shadije Gërguri, prokurorja Drita Hajdari.

Enver Hasani ishte ngritur më 13 janar 2016, ndërsa seanca fillestare është mbajtur tek më 8 shtator 2016, përkundër faktit që Kodi i Procedurës Penale të Kosovës përcakton se seanca fillestare mbahet 30 ditë pas ngritjes së aktakuzës.<sup>24</sup>

Në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në rastin me numër të lëndës PKR.nr.458/16, seanca fillestare është mbajtur me 14 tetor 2016, ndërsa aktakuza ndaj Arben Bashotës, Sylejman dhe Osman Bajramit ishte ngritur më 10 gusht 2016. Të gjithë të akuzuarit deri në shqyrtimin e dytë kanë qenë në paraburgim, ndërsa akuzohen për krim të organizuar lidhur me veprën e detyrimit<sup>25</sup>.

Në rastin ku akuzohet Azem Syla dhe 21 persona të tjerë për krim të organizuar lidhur me prona shoqërore, aktakuza është ngritur me datë 25 tetor 2016, ndërsa deri në datën kur po shkruajmë këtë raport, shqyrtimi fillestar nuk është mbajtur ende, përkundër se disa prej të akuzuarve janë në paraburgim siç është rasti i Azem Sylës, Ilaz Sylës etj<sup>26</sup>.

Rastet e tilla të caktimit të seancave fillestare deri në gjashtë muaj pas ngritjes së aktakuzës në rastet kur të akuzuarit gjenden në paraburgim, e po ashtu vonesat deri në tetë muaj nga shqyrtimi fillestar në shqyrtimin e dytë gjyqësor, konsiderohen neglizhencë e drejtpërdrejtë e gjyqtarëve dhe dështim i tyre për të kryer lëndët në afatet e parapara ligjore.

BIRN dhe I/KS e shohin shqetësues faktin që gjyqtarët nuk respektojnë dhe tejkalojnë afatet e përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale. Vazhdimi edhe më tutje i lejimit të tejkalimit të afateve gjyqësore ndikon në mos efikasitetin e gjyqësorit për trajtimin e lëndëve në afat të arsyeshëm ndaj kryesve të dyshuar të veprave penale të cilët ndodhen në masën e paraburgimit.

---

24 Gjykatësi individual Shashivar Hoti, prokurori Abdurrahim Islami, i akuzuari Enver Hasani me avokat Bajram Tmava.

25 Kryetari i trupit gjykues Arben Hoti, prokuror Merita Bina- Rugova.

26 Prokurori Danilo Cecareli, gjykatësi Arcadiuzc sedek.

## SHKELJET PROCEDURALE GJATË SEANCAVE GJYQËSORE

Gjatë vitit 2016 janë monitoruar 686 seanca gjyqësore duke përfshirë çështjet penale dhe ato civile, nga të cilat janë gjetur shumë shkelje procedurale të bëra nga prokurorët, avokatët dhe nga vet gjyqtarët dhe trupi gjykues.

Të gjeturat e monitoruesve si shkelje procedurale gjatë vitit 2016 në tërë territorin e Republikës së Kosovës janë të ndryshme. Duke u nisur nga e drejta e të pandehurit për t'u informuar në gjuhën që e flet, mosmbajtja e rendit gjatë procesit gjyqësor, moskonstatimi i gjendjes reale në procesverbalin gjyqësor, moslargimi i dëshmitarëve nga salla e gjykimit, mosdërgimi i ftesave me rregull nga gjykata, mospërgatitja e prokurorëve për gjykim, caktimi i dy seancave gjyqësore në të njëjtën kohë, mbajtja e gjykimit pa përbërjen e plotë të trupit gjykues, sjellja me vonesë nga qendra e paraburgimit, ndërrimi i deklaratave të dëshmitarëve, mosrespektimi i afateve ligjore, e deri tek shtyrjet e panevojshme të seancave gjyqësore dhe problemet teknike gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore.

Në vazhdim, janë të prezantuara në detaje shembuj konkretë sa i përket shkeljeve të gjetura në rastet e monitoruara gjatë mbajtjes së seancave gjyqësore si për rastet penale ashtu edhe për ato civile.

### E drejta e të pandehurit për t'u informuar në gjuhën që e flet

Në rastin me numër të lëndës P.nr.3851/15 të mbajtur në Gjykatën Themelore të Prishtinës, për shkak të veprës penale “Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare” nga neni 437 par.1 të KPRK-së, prokurori nuk e kishte sjellur aktakuzën në gjuhën serbe, pasi që i akuzuari ishte i nacionalitetit serb. Po ashtu gjyqtarja lejoi që seanca fillestare të mbahet pa e pasur i akuzuari aktakuzën në gjuhën e tij. Kjo u bë me pajtimin e të akuzuarit, i cili nuk kishte avokat mbrojtës. Gjyqtarja e rastit në fund e obligoi prokurorin që pas tri ditësh ta sjellë në gjykatë aktakuzën e përkthyer në gjuhën serbe, e cila më pas do t'i dërgohej të akuzuarit<sup>27</sup>.

Rasti konkret ka të bëjë me shkelje esenciale të procedurës penale, ngase gjuha të cilën e flet vetë i pandehuri është e garantuar me nenin 14 par.2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, në të cilin thuhet:

“personi i cili merr pjesë në procedurë penale i cili nuk e flet gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, ka të drejtë të flasë gjuhën e vet dhe të jetë i informuar nëpërmjet përkthimit pa pagesë me faktet, provat dhe procedurën”.

Ndërsa në seancën tjetër gjyqësore me numër të lëndës Pkr.733/14 të mbajtur më 16 qershor 2016 në Gjykatën Themelore të Prishtinës- Departamenti i Krimeve të Rënda, për shkak të veprës penale Përvetësimi në detyrë nga neni 425 i KPRK-së, gjatë leximit të aktgjykimit i akuzuari nuk pati përkthyes në gjuhën e tij, duke u bërë shkelje procedurale

<sup>27</sup> Gjyqtarja: Naime Jashanica, prokurori: Meduhi Kastrati, i akuzuari: Srdian Jeriniq. Seanca gjyqësore e mbajtur më 9.02.2016.

e të drejtave të të pandehurit. E drejtë kjo e garantuar në nenin 14 të Kodit të Procedurës Panele të Kosovës<sup>28</sup>.

## Mosmbajtja e rendit gjatë procesit gjyqësor

Në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Krime të Rënda, në rastin penal PKR.nr. 717/15, të mbajtur për shkak të veprës penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 375 par.1 të KPRK-së, pasi avokatët përfunduan kundërshtimin e fjalës së tyre gjyqtari i dha fjalën të akuzuarit Albin Kurti, duke i thënë se “ndonëse nuk është e lejuar me ligj po bëj një përjashtim për t’iu dhënë mundësinë të jepni kundërshtimin tuaj”. Kjo bëri që i akuzuari t’i drejtohet gjyqtarit “Pse pra po e shkelni ligjin?”

Në rastin konkret, pavarësisht qëllimit, gjyqtari duhet të jetë më i kujdesshëm në udhëheqjen e kësaj lënde dhe të mos tregojë tolerancë të tepruar duke shkelur ligjin dhe të lejojë polemika me të akuzuarit<sup>29</sup>.

## Avokatët Prishin Rendin në Gjykatore

Në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në rastin me numër të lëndës Pkr.314/13, të mbajtur më 10 mars 2016 për shkak të veprës penale të Vrasjes së Rëndë nga neni 179 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, një ndër problemet e paraqitura ishte marrja e fjalës nga avokati pa rend, çka e shtyri trupin gjykues t’ia tërheqë vërejtjen.<sup>30</sup>

Avokati Tomë Gashi disa herë e ndërpreu trupin gjykues, po ashtu edhe i jepte sugjerime se çka të vendosej në procesverbal. Në momentin kur i akuzuari Shpejtim Bajrami i drejtohet kryetarit të trupit gjykues me fjalën “ti”, avokati Gashi, i drejtohet kryetarit të trupit gjykues me fjalët “fute këtë fjalë në procesverbal”. Kjo e shtyri kryetarin e trupit gjykues Faik Hoxha që t’ia tërheqë vërejtjen avokatit Gashi “ose mbani rend në gjykatore ose po e ndërprejmë seancën.

Po ashtu në [Gjykatën Themelore të Prishtinës](#), në rastin Përvetësimi në detyrë neni 425 par.1 i KPRK-së, me numër të lëndës Pkr.295/14 të mbajtur më 10 mars 2016, avokati Ali Latifi përdori telefonin dhe për këtë kryetari i trupit gjykues ia tërhoqi vërejtjen.

Avokati Latifi, më pas doli nga seanca pa lejen e trupit gjykues dhe për këtë kryetari i trupit gjykues e evidentoi në procesverbal duke shkruar se e përjashtoi nga ky proces gjyqësor.<sup>31</sup>

Pas dy- tre minutash avokati Ali Latifi sërish u kthye në sallë të gjykimimit dhe në atë moment u njoftua nga kryetari i trupit gjykues se e ka përjashtuar nga ky proces gjyqësor dhe se për këtë do ta njoftojë Odën e Avokatëve. Më pas ndërhyri avokati Ali Beka i cili e

28 Gjykatësi individual Suzana Qerkini, prokurori Dulina Hamifi, i akuzuari Millan Millanoviç,

29 Gjyqtari individual: Beqir Kalludra, prokurorë: Fikrije Fejzullahu Krasniqi, të akuzuarit dhe avoketët: Albin Kurti - av. Hedije Ademi, Albulena Haxhiu av. Ahmeti Ahmeti, Faton Topalli - av. Haxhi Millaku dhe Donika Kadaj-Bujupi. Seanca gjyqësore u mbajt më 23.02.2016

30 Kryetar i trupit gjykues Faik Hoxha, anëtarët Valbona Selimaj dhe Nora Bllaca, i akuzuari Shpejtim Bajrami me avokat Bedri Krasniqi, të dëmtuar Familja Rekalii me përfaqësues avokat Tomë Gashi.

31 Gjyqtari individual Beqir Kalludra, prokurori Shadie Gërguri, të akuzuarit Bahri Shabani (av. Basri Jupolli dhe Haxhi Millaku), Rrahman Emini (av. Ali Latifi), Sami Rrahmani (av. Ali Beka), I dëmtuari BSPK.



luti kryetarin e trupit gjykues që ta tërheqë vendimin për përjashtimin e avokatit Latifi. Edhe avokati Ali Latifi kërkoi falje për veprimin e tij.

Kryetari i trupit gjykues çuditërisht më pas e tërhoqi vendimin për përjashtimin e avokatit Latifi.

## Mos Konstatimi i Plotë në Procesverbal

Në Gjykatën Themelore të Prizrenit, në rastin me numër të lëndës 278/14 të mbajtur më 29.02.2016 për shkak të veprës penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkrerje nga neni 422 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, kryetarja e trupit gjykues nuk i shënonte në procesverbal kundërshtimet e prokurorit të shtetit, Mehdi Sefa, ndaj pyetjeve të avokatëve në disa raste. Ajo nuk e lejonte as të bëjë kundërshtimin, ndërsa në disa raste edhe pse prokurori e bënte kundërshtimin, ajo nuk e shënonte fare në procesverbal.<sup>32</sup>

## Mosdërgimi i Ftesave Me Rregull nga Gjykata

Në Gjykatën Themelore të Pejës, më 17 mars 2016, për shkak të veprës penale Trafikim me Njerëz nga neni 139 par 1. të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, e cila mban numrin e lëndës P.nr.170/14 seanca gjyqësore nuk u mbajt.

Arsyeja e mosmbajtjes së kësaj seance gjyqësore ishte për shkak të mungesës së të pandehurve, të cilët doli se nuk ishin ftuar me ftesa të rregullta për pjesëmarrje në seancë nga ana e Gjykatës.<sup>33</sup>

Poashtu, në Gjykatën Themelore të Prizrenit- dega në Suharekë, në çështjen civile "kontest prone" me numër të lëndës C.nr.210/13 të mbajtur më datë 10 mars 2016, në seancë munguan të paditurit dhe përfaqësuesit e tyre. Avokatët Shpresa Berisha e Shemsije Sheholli, nga shkresat e lëndës shihet se nuk ka fakte se janë ftuar në mënyrë të rregullt. Për më tepër, avokatja Shemsije Sheholli është ftuar në adresën që e ka në padi, por ftesa është kthyer nga PTK-ja, pa asnjë sqarim.<sup>34</sup> Gjykata mori aktvendim që seanca gjyqësore të mos mbahet dhe e njëjta u shty për një datë tjetër (datë 15 prill 2016).

## Moslargimi i Dëshmitarëve Nga Salla e Gjykimit

Në seancën gjyqësore të mbajtur më 16 mars 2016, për veprën penale të keqpërdorimit të detyrës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 i KPRK-së, në Gjykatën Themelore të Prishtinës me numër të lëndës PkR.18/15, dy dëshmitarë që ishin në radhë për të dëshmuar, (njëri nga dëshmitarët Arbër Krasniqi) qëndruan në sallë që nga fillimi i seancës gjyqësore, derisa dëshmitari Granit Hasani jepte dëshminë e tij para trupit gjykues.<sup>35</sup>

<sup>32</sup> Kryetarja e trupit gjykues Ajser Skender me anëtarët Kimete Kicaj dhe Luan Berisha, prokurori Mehdi Sefa, të akuzuarit: Nexhat Çoçaj me avokat Bashkim Nevzati, Bekim Thaçi me avokat HyLki Kurtaj, Bedri Çeku me avokat Osman Zajmi.

<sup>33</sup> Kryetar i trupit gjykues Sami Sharraxhiu, anëtarët Violeta Husaj Rugova dhe Sali Berisha, të akuzuarit: Dritunie Hoti, Kristë Tomaj, Nasuf Bardhi, Ardian Marku. E dëmtuar: Afrora Sylaj,

<sup>34</sup> Gjykatës Shaban Zeqiraj, paditës Shyhrete Berisha me avokat Naim Qelaj, të paditur Arben e Xhelal Berisha me avokatët Shpresa Berisha dhe Shemsije Sheholli.

<sup>35</sup> Kryetari i trupit gjykues Vladimi Mikula, anëtarët Alltene Mureseli dhe Arcadius Sedek, prokurori

Në një rast tjetër në Departamentin e Krimeve të Rënda në [Gjykatën Themelore të Prishtinës](#), të mbajtur më datë 06 shtator 2016, në lëndën me numër Pkr.nr. 362/16, për shkak të veprës penale Shpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 339 dhe Mashtrimi në detyrë nga neni 341 të KPK-së, dëshmitari Bajram Kosumi, para se të japë dëshminë e tij si dëshmitar, gjatë gjithë kohës ka qenë i pranishëm në seancë derisa trupi gjykues prezantonte të metat dhe shkeljet që i ka gjetur Gjykata e Apelit në këtë lëndë (pasiqë e njëjta është kthyer në rigjykim, për shkak të shkeljeve esenciale të aktgjykimit)<sup>36</sup>.

Neni 330 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës përkufizon saktë mënyrën e marrjes në pyetje të dëshmitarit në shqyrtimin gjyqësor;

“Në parim, dëshmitari i cili ende nuk është marrë në pyetje, nuk është i pranishëm gjatë shqyrtimit të provave dhe eksperti i cili ende nuk ka dhënë konstatimin dhe mendimin e tij, nuk mund të jetë i pranishëm në seancë derisa eksperti tjetër të japë deklarinim e tij mbi çështjen e njëjtë”.

### Caktimi i Dy Seancave Gjyqësore në të Njëjtën Kohë

Në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore të Prishtinës, në rastin Vjedhje nga neni 252 par.1 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, me numër të lëndës P.nr. 2101/11, gjyqtarja e rastiit në të njëjtën kohë kishte caktuar dy seanca gjyqësore. Seanca gjyqësore me numër të lëndës P.nr. 2101/11 ishte thirrur të mbahej në ora 09:30 ndërsa filloi në ora 10:50, gjatë kësaj kohe për rreth një orë e gjysmë palët pritën në korridor të gjykatës derisa gjykatësja përfundoi lëndën tjetër të cilën e kishte caktuar në të njëjtën kohë.<sup>37</sup>

### Përgatitja e Dobët e Prokurorëve Për Gjykim

Në Departamentin e Krimeve të Rënda në Gjykatën Themelore të Gjilanit, në rastin e korrupsionit, saktësisht të veprës penale “Keqpërdorimi i detyrës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 par.2 të KPK-së, të mbajtur më datë 31 mars 2016, prokurori i rastiit Shaban Spahiu, sapo hyri në seancë tha se nuk e ka ditur që ka gjykim!

Prokurori kërkoi nga gjyqtari i rastiit që t’ia japë një kopje të aktakuzës pasi që nuk kishte marrë lëndën me vete dhe kishte ardhur për të përfaqësuar Prokurorinë e Shtetit në një rast korrupsioni plotësisht i papërgaditur.<sup>38</sup>

---

Charles Hardaëay, të akuzuarit Esat Tahiri-av. Armend Krasniqi, Milazim Lushtaku-av. Artan Qerkini, Arben Gjuka-av. Ramë Gashi, Driton Pruthi-Av. Bajram Tmava, Hysni Hoxha-av. Sahit Bibaj, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku- av. Arianit Koci, të dëmtuarit Besa Security.

36 Kryetare e trupit gjykues Suzana Qerkini, antërë; Arben Hoti dhe Agim Kuqi, prokuror; Hivzi Bajraktari, të akuzuarit; Astrit Haraqija(av. Teki Bokshi) Valton Beqiri(av. Shpresa Berisha) Armond Morina(av. Arianit Koci) Nehat Fejza (av. Osman Havolli), e dëmtuar; Ministria e Kulturës.

37 Gjyqtarja Naime Krasniqi- Jashanica, prokuror Hava Krasniqi, i akuzuari Hetem Ahmeti, i dëmtuar KEK.

38 Gjyqtari Naser Maliqi, prokurori Shaban Spahiu, i akuzuari Naim Pira.

“Këtë problem do ta kemi në vazhdimësi përderisa nuk do të kemi numër të mjaftueshëm të prokurorëve. Më vjen keq që po e them këtë për çdo vit, por derisa një prokuror shkon në një seance gjyqësore të përfaqësojë një akuzë të kolegut të tij i cili gjendet në një tjetër gjykim, atëherë normalisht që ky nuk do të jetë i denjë në përfaqësim, sepse nuk e njeh lëndën dhe nuk i ka bërë vetë hetimet”.

Besim Kelmendi – Prokuror i Prokurorisë së Shtetit

Në një rast tjetër në **Gjykatën Themelore të Prishtinës**, në rastin PKR.nr.252/16 të mbajtur më 14 Tetor 2016, për shkak të veprave penale; Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273, Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 372 dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 i KPRK-së, prokurorja e rastit në seancë kishte ardhur e papërgatitur.

Edhe seanca e kaluar në këtë rast ishte shtyrë pasi që prokurorja nuk i kishte ofruar mbrojtjes të gjitha provat, përkatësisht një CD që përmbante xhirimin e vendit të ngjarjes. Në seancën e kaluar trupi gjykues e kishte obliguar prokuroren që ta bënte shumëzimin e kësaj CD-je që t'i ofrohet mbrojtjes, por këtë nuk e kishte bërë prokurorja! Prokurorja, po ashtu në seancën e kaluar kishte thënë se do të bënte edhe precizimin e provave për këtë rast, por as në këtë seancë nuk ishte në gjendje ta bënte. Trupi gjykues, i gjendur para një situatë të tillë, u obligua ta shtynte seancën pasi që prokurorja ishte totalisht e papërgatitur<sup>39</sup>.

## Marrja e Kundërligjshme Në Pyetje Nga Ana e Prokurorit

Në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në lëndën me numër Pkr. 86/13, të mbajtur më 28 Tetor 2016 për shkak të veprës penale Vrasje e Rëndë nga neni 179 i KPRK-së, Prokurori i rastit mori në pyetje dëshmitarin në kundërshtim me nenin 333 par.1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Prokurori, me dhjetëra herë ka bërë pyetje indirekte dëshmitarit përkundër faktit se dëshmitari Fahrudin Radonçiq ishte i ftuar nga ana e prokurorit dhe prokurori obligohet që t'i parashtrojë vetëm pyetje direkte. Prokurori Hughes, madje ka marrë vërejtje nga ana e kryetares së trupit gjykues, për shkak të parashtrimit të pyetjeve indirekte.

Gjithashtu një element i veçantë në këtë rast, ishte fakti se prokurori e ka cilësuar si “dëshmitar armiqësor” dëshmitarin e ftuar nga ai, term ky i cili nuk ekziston fare as si koncept në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës<sup>40</sup>.

39 Kryetari i trupit gjykues; Valbona Selimaj, anëtarët; Nora Blaca dhe Faik Hoxha, prokurorja; Ferdane Sylejmani, të akuzuarit; Arsim Fazliu me avokat Behar Ejupi, Hysen Lala me avokat Basri Jupolli, Naser Miftari me avokat Selman Bogiqi.

40 Kryetari i trupit gjykues; Ana Adamska Gallant, anëtarët; Syzana Qerkini dhe Mariola Pasnik, prokurori; Andreë Hughes, i akuzuari; Naser Kelmendi me avokat Besnik Berisha, i dëmtuar; Familja e Ramiz Delatij.

## Sjellja me Vonesë Nga Qendra e Paraburgimit

Në Departamentin e Krimeve të Rënda, në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në seancën gjyqësore me numër të lëndës PKR.nr. 218/14 të mbajtur më 12.04.2016, për shkak të veprave penale “Vrasje e Rëndë” nga neni 147 par.3 dhe 9 lidhur me nenin 24 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës<sup>41</sup> seanca filloi me një orë e gjysmë vonesë për shkak se i akuzuari nuk ishte sjellë me kohë nga qendra e paraburgimit.

Po ashtu në një rast tjetër, në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në seancën gjyqësore me numër të lëndës PKR 375/14, të mbajtur më 27.10.2016, për shkak të veprës penale Vrasje e Rëndë, seanca ishte e paraparë të fillonte nga ora 09:00 por nuk filloi deri në orën 11:00 për shkak se i akuzuari nuk është sjellë me kohë nga njësi i transportit në gjykatë<sup>42</sup>.

## Mbajtja e Gjykimit Pa Përbërjen e Plotë të Trupit Gjyqësor

Në rastin me numër të lëndës PKR.nr.133/15 të mbajtur më datë 24.05.2016 në Gjykatën Themelore të Prishtinës, për shkak të veprës penale “Vrasje e Rëndë” nga neni 179 i KPK-së, anëtarja e trupit gjyqësor Valbona Selimaj, ende pa përfunduar seanca doli nga salla e gjykimit dhe u kthye pas rreth 10 minutave. Kryetari i trupit gjyqësor nuk e ndërpreu seancën gjyqësore, por vazhdoi gjykimin vetëm me një anëtar të trupit gjyqësor<sup>43</sup>.

Sipas nenit 19 par.1 nënpar 1.22 të KPPRK-së, Trupi gjyqësor përbëhet prej kryetarit të trupit gjyqësor dhe dy gjyqtarëve profesionalë të cilët shqyrtojnë provat dhe gjykojnë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në rastin konkret, edhe përkundër faktit që njëri nga anëtarët e trupit gjyqësor nuk ishte prezent një gjë e tillë nuk u konstatua fare në procesverbal dhe kryetari i trupit gjyqësor lejoi që gjykimi të vazhdojë në procedurë të provave pa prezencën e njërit nga anëtarët e trupit gjyqësor, të cilit më vonë do t'i duhet të jetë pjesë e vendimmarrjes pa qenë fare i pranishëm në seancë.

Veprimet e tilla janë bazë e mjaftueshme për prishje të lëndës nga shkalla e dytë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nënpar 1.1 dhe 1.3 të KPPRK-së, sipas së cilave shkelja esenciale e dispozitave procedurale përbën rastet kur përbërja e trupit gjyqësor nuk ka qenë në pajtim me ligjin, ose kur shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa persona, prania e të cilëve në shqyrtim gjyqësor kërkohet me ligj. Neglizhenca e tillë dhe lejimi i shkeljeve të tilla nga trupi gjyqësor, bën që rasti të kthehet në rigjykim për shkak të shkeljeve esenciale dhe njëkohësisht paraqet prolongim dhe dyfishim të kohës për kryerjen e një lënde dhe po ashtu i paraqet buxhetit të shtetit shpenzime të panevojshme procedurale, të cilat nuk do të ndodhnin nëse trupi gjyqësor do të ishte i kujdesshëm gjatë mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor.

41 Trupi gjyqësor: Arcadius Sedek, Naser Foniqi dhe Mariola Pasnik, i akuzuari: Enver Sekiraqa-av.Bostjan Penko dhe Kosovare Kelmendi, I dëmtuari: familja Riza

42 Kryetarja e trupit gjyqësor: Ana Adamska Gallant, anëtarët: Syzana Qerkini dhe Mariola Pasnik, prokurori: Andreë Hughes, I akuzuari: Naser Kelmendi me avokat Besnik Berisha, I dëmtuar: Familja Delatic.

43 Trupi gjyqësor: Faik Hoxha, Valbona Selimaj dhe Nora Bllaca, prokurori: Mirushe Llugiqi, të akuzuarit: Besim Istrefi (av. Bajram Sherifi), Besart Istrefi (av. Ali Beka), Jeton Saraqi (av. Mentor Neziri), të dëmtuar: Familja Gërvalta.

## Ndërrimi i Deklaratave të Dëshmitarëve

Në seancën gjyqësore të mbajtur në Gjykatën Themelore të Prishtinës më 29.04.2016 për shkak të veprave penale “nxitje në vrasje” në kundërshtim me nenin 24 dhe nenin 147 (3) dhe (9) të KPK-së, “Detyrim”, në kundërshtim me nenin 267 paragrafët (1) dhe (2) të KPK-së, “Dhunim” në kundërshtim me nenin 193 paragrafi (1) dhe (2), në lëndën me numër PKR.nr.218/14<sup>44</sup>, Prokurori Carney, në fjalën e tij përfundimtare, tha se është dukuri e shprehur në Kosovë që shumë dëshmitarë t'i ndërrojnë deklaratat e tyre nga ato që fillimisht i japin në prokurori! Carney, po ashtu ka qenë shumë i nervozuar me një ekspertizë që ishte bërë gjatë gjykimit, duke e quajtur atë ekspertin si amatore dhe absurde në llojin e saj. Ekspertja e këtij rasti ka qenë Safete Gashi-Naka, Prokurori Carney e ka quajtur ekspertizë absurde në fjalën e tij përfundimtare. Sipas ekspertës, Naka, Triumf Riza ishte i dehur në momentin e vrasjes së tij. Ajo deri tek kjo gjetje ka ardhur pasi që ka llogaritur nivelin e konstatuar të alkoolit në gjakun e Rizës në momentin e autopsisë dhe duke pretenduar se për çdo orë që kalon niveli i alkoolit zvogëlohet, ka konstatuar se sasia e alkoolit në gjakun e Triumf Rizës në momentin kur u qëllua ka qenë shumë më e lartë se kur i është bërë autopsia. Prokurori dhe trupi gjykues nuk janë pajtuar me këtë ekspertizë andaj atë e kanë dërguar për një ekspertizë tjetër në Zagreb. Rezultatet e ekspertizës nga Zagrebi nuk kanë qenë në përputhje me rezultatet e ekspertës Naka.



“Duhet të organizohemi të gjithë gjyqtarët që merren me çështje civile që seancat e tyre ti mbajnë në salla të gjykimit, sepse dikush është i interesuar të shkojë në salla të gjykimit e disa gjyqtarë të tjerë më lehtë i kryejnë seancat në zyre sesa të ndërrojnë objektet sepse duhet bartur lëndët nga një objekt në tjetrin” .  
**FATON BAJRAMI,  
GJYKATËS**

### Mbajtja e gjykimit në zyre e jo në sallë të gjykimit

Në seancën gjyqësore të mbajtur më 26 prill 2016 në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në lëndën civile “vërtetim pronësie” me numër C.nr.362/11 , seanca gjyqësore u mbajt në zyre të gjykatësit edhe pse në të njëjtin moment në të njëjtën ndërtesë kanë qenë së paku 5 salla të lira për t'u mbajtur seanca gjyqësore.

Të pranishëm në seancë ishin 12 persona duke përfshirë gjykatësin, sekretaren juridike, paditësen me avokaten e saj, katër të paditur, avokati i dy të paditurave, dy praktikantë dhe monitoruesi nga BIRN dhe I/KS.

Pos mungesës së ajrit në atë zyre të mbyllur, paditësja me avokaten e saj dhe të paditurit ishin të ulur pranë njëri tjetrit që shpesh ndikonte që ata të bënin dialog ndërmjet tyre dhe duhej intervenimi i gjyqtarit që ta qetësonte situatën e krijuar aty.

Gjykatësi i rastit, Faton Bajrami, tha se atij i është thënë se nuk ka vende të lira në atë objekt sepse ka shumë seanca gjyqësore nga Departamenti për Krime të Rënda.

“Duhet të organizohemi të gjithë gjyqtarët që merren me çështje civile që seancat e tyre t'i mbajnë në salla të gjykimit, sepse dikush është i interesuar të shkojë në salla të gjykimit e disa gjyqtarë të tjerë më lehtë i kryejnë seancat në zyre sesa të ndërrojnë objektet sepse duhet bartur lëndët nga një objekt në tjetrin”, tha gjykatësi Bajrami.

44 Trupi gjykues: Arcadiusz Sedek, Mariola Pasnik dhe Naser Foniqi, prokurori: Andreë Carney, i akuzuari: Enver Sekiraqa me avokatë Bostjan Penko dhe Kosovare Kelmendi, të dëmtuar: Familja e Triumf Rizës.

## Shtyhet Seanca- Prokurori nuk është i pranishëm në Gjykim

Më 21 qershor 2016 në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në lëndën me numër PKR.nr. 32/2015, për shkak të veprës penale vrasje në tentativë, seanca gjyqësore nuk u mbajt. Seanca nuk është mbajtur për shkak të mungesës së prokurorit Ilaz Beqiri, i cili nuk është paraqitur në gjykim dhe nuk e ka paralajmëruar mungesën e tij. Kryetarja e trupit gjykues Afërdita Bytyqi ka thënë se do ta lajmërojë kryeprokurorin për këtë mungesë e cila bëri që seanca të shtyhet. Për më tepër në seancë ka munguar edhe i akuzuari në çastin e fillimit të seancës por ai ka qenë rrugës duke ardhur në gjykim<sup>45</sup>.

Po ashtu, në një rast tjetër në [Gjykatën Themelore të Prishtinës](#)- Departamenti i Krimeve të Rënda, në lëndën me numër PKR.nr.205/08, e planifikuar të mbahej më 12 gusht 2016, për shkak të veprës penale "Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës" nga neni 340 i KPPRK-së, seanca gjyqësore nuk u mbajt.

Mungesa e prokurorit Hivzi Bajraktari, bëri që seanca gjyqësore të dështojë. Kryetari i Trupit Gjykues, Shashivar Hoti, ka njoftuar palët se ditën e seancës ka arritur parashpresa që ka njoftuar se prokurori do të mungojë për shkak se është në pushim. Në këtë rast është treguar jo seriozitet nga ana e prokurorit të rastit nga fakti se kjo lëndë neglizhohet duke u endur nëpër gjykata nga viti 2008. Si rezultat i kësaj gjendjeje, prokurori nuk do të duhej në asnjë mënyrë të ishte shkaktar i shtyrjes së seancës.

Gjithashtu, ndonëse kjo seancë gjyqësore nuk është mbajtur, kryetari i trupit gjykues, Shashivar Hoti ka hyrë në seancë me vetëm një anëtare të trupit gjykues, gjyqtaren Shpresa Hasaj Hyseni, ndërsa mungoi anëtari tjetër Nexhmedin Sejdiu. Trupi gjykues duhet të jetë tërë kohën i plotë dhe asnjë veprim nuk guxon të ndërmerret pa prezencën e të tre anëtarëve të trupit gjykues<sup>46</sup>.

Në rastin tjetër në [Gjykatën Themelore të Prishtinës](#), në lëndën me numër Pkr. 622/15, të planifikuar të mbahej më 17 Nëntor 2016 për shkak të veprës penale të Keqpërdorimit të detyrës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 i KPRK-së, seanca nuk u mbajt fare për arsye se prokurorja Besa Krajkun ndonëse ka qenë në Pallatin e Drejtësisë, ishte e angazhuar në një seancë tjetër. Kryetari i trupit gjykues njoftoi se ajo ka qenë e angazhuar me një rast me paraburgim.

Edhe përkundër faktit që rastet me paraburgim janë me prioritet, kjo asesi nuk do të duhej të arsyetohej me shtyrjen e seancës për mungesë të prokurorit, pasi që edhe rastet e korrupsionit janë raste me prioritet.

Për më tepër në këtë lëndë ka pasur shtyrje edhe më herët. Seanca për shkak të mungesës së Lutzim Gashit është shtyrë edhe më datë 1 nëntor, ndërsa për shkak të mungesës së anëtarit të trupit gjykues, seanca ishte shtyrë edhe më herët, më 18 tetor pasi që gjyqtari

45 Trupi gjykues: Afërdita Bytyqi kryetare, Arben Hoti dhe Syzana Qerkini anëtarë, prokurori Feti Tunuzliu, i akuzuari Sahit Sopa, i dëmtuari Rahman Arifoviq.

46 Kryetari trupit gjykues Shashivar Hoti, njëra anëtare Shpresa Hasaj Hyseni, prokurori Hivzi Bajraktari, të akuzuarit Sami Zeneli dhe Mehmet Gerguri, e dëmtuar Biblioteka Kombëtare e Kosovës.

Shashivar Hoti ishte i angazhuar me një seancë tjetër<sup>47</sup>.

## Shtyrhet Gjykimi Për Shkak të Neglizhencës së Gjykatës

Në seancën gjyqësore me numër PKR.NR.66/2016 të planifikuar të mbahej më 7 korrik 2016 në Gjykatën Themelore të Gjiçanit- Departamenti i Krimeve të Rënda, për shkak të veprës penale “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist” nga neni 143 i KPRK-së, seanca gjyqësore nuk u mbajt fare. Shtyrja ka ndodhur për shkak të neglizhencës së gjykatës. Kryetari i trupit gjykues njoftoi që gjykata ka harruar t’i dërgojë urdhëresë Policisë së Kosovës që i akuzuari për terrorizëm të sillet në gjykatë.

Avokati i të akuzuarit, shprehu pakënaqësinë e tij duke përmendur faktin se shtyrja e këtij gjykimi dëmton më së shumti të akuzuarin. Nga ana tjetër, kryetari i trupit gjykues u arsyetua se gabime të tilla ndodhin ngase janë teknike<sup>48</sup>.

## Mosleximi aktakuzës dhe mospajisja me aktakuza për avokatët

Në seancën gjyqësore të mbajtur më 6 qershor 2016, në Gjykatën Themelore të Prishtinës- Departamenti i Krimeve të Rënda, në lëndën me numër Pkr. 72/2014, për shkak të veprës penale Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike nga neni 274 par. 1 si dhe vepra penale Dokumentet e rrejshme lidhur me tatimin nga neni 314 par 2 të KPRK-së, pati disa shkelje procedurale penale.

Në këtë seancë, përkundër se ishte shqyrtimi fillestar, nuk është lexuar aktakuza, ndërsa këtë nuk e kundërshtuan asnjëra nga palët e pranishme në seancë. Leximi i aktakuzës në seancën fillestare është obligative dhe evitimi i leximit të aktakuzës përbën shkelje procedurale e njëkohësisht dëmton rëndë edhe parimin e publicitetit pasi në një rast si ky i korrupsionit vështirësohet roli i medias në informim të drejtë se për çka akuzohen të akuzuarit sepse u mohohet dëgjimi i aktakuzës.

Gjithashtu shkelje tjetër edhe më flagrante është se në këtë seancë dy avokatë nuk kanë qenë të pajisur me aktakuzë, gjë e cila cenon të drejtën e avokatëve dhe të akuzuarve ngase mos pajisja e avokatëve me aktakuzë pamundëson deklarinim e të akuzuarëve rreth pranimi të fajësisë<sup>49</sup>.

## Në Paraburgim mbi 3 vjet pa Nxjerrë Asnjë Aktgjykim

Në Gjykatën Themelore të Gjakovës, në lëndën me numër PKR.nr.250/13, e planifikuar të mbahet më datë 27 qershor 2016, për shkak të veprave penale “vrasje” nga neni 178, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 dhe vepra penale “Lëndimi i lehtë trupor” nga neni 188 i KPRK-së, i akuzuari Nikollë Shyti gjendet në

47 Kryetari i trupit gjykues; Elmaz Zenuni, anëtarët; Valon Kurtaj dhe Shashivar Hoti, prokurori; Besa Krajku, i akuzuari; Lutzim Gashi me avokat Asman Gashi.

48 Kryetar i trupit gjykues Agim Ademi, anëtarët Ramush Ademi dhe Naser Maliqi, prokurori Elez Blakaj, i akuzuari Vilson Halili me avokat Abdylaziz Sadikun.

49 Gjykatësi individual Elmaz Zenuni, prokurori Faik Halili, të akuzuarit Blerim Sinani, Skender Sinani, Fatmir Sinani, Isa Derguti, Sabit Sogojeva, Enver Hasani dhe Mentor Emiri, i dëmtuar Buxheti i Kosovës.

paraburgim për më shumë se 3 vjet ende pa u nxjerrë asnjë aktgjykim<sup>50</sup>.

## Mos respektimi i afatit ligjor për mbajtjen e shqyrtimit fillestar

Në seancën gjyqësore me numër të lëndës P.kr.14/16 në Gjykatën Themelore të Prishtinës, të mbajtur më 09 shtator 2016 për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, aktakuza ndaj të pandehurit ishte ngritur më 13 janar 2016, ndërsa seanca fillestare është përfunduar tek më 8 shtator 2016, përkundër faktit që Kodi i Procedurës Penale të Kosovës përcakton se seanca fillestare mbahet 30 ditë pas ngritjes së aktakuzës<sup>51</sup>.

Në rastin tjetër në [Gjykatën Themelore të Prishtinës](#), në lëndën me numër Pkr. 369/16, të mbajtur më 20 Tetor 2016 për shkak të veprave penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2, si dhe Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par. 1 dhe 4 të KPRK-së, edhe pse vepra penale nga kapitulli i veprave të korrupsionit për të cilat raste është paraparë trajtim me prioritet, aktakuza në këtë rast është ngritur më 15 qershor 2016, ndërsa seanca fillestare është mbajtur pas katër muajsh, më 20 tetor 2016<sup>52</sup>.

## Qëndrimi i gjatë në paraburgim deri në shqyrtimin e dytë gjyqësor

Në Departamentin e Krimeve të Rënda pranë Gjykatës Themelore të Prizrenit, në rastin PKR.nr.85/16 të mbajtur më 17.10.2016, për shkak të veprave penale Krim i Organizuar, Shpërlarje e parave, Fajde dhe detyrim, të akuzuarit gjenden në paraburgim nga muaji Maj i vitit 2015, ndërsa seanca e shqyrtimit të dytë u mbajt në muajin tetor të vitit 2016, pas plot 17 muajve qëndrimi në paraburgim, ende pa hyrë lënda në shqyrtim kryesor<sup>53</sup>.

Në këtë seancë gjyqësore pati probleme qysh në fillim. Njëri ndër problemet kryesore ishte fakti se avokatët mbrojtës nuk kishin ku të uleshin dhe ku t'i vendosnin dosjet e tyre (të cilat ishin shumë voluminoze për shkak të rastit). Avokati Hazër Susuri reagoi te trupi gjyqësor se fillimisht nuk pati as vend ku të ulej, e pastaj u ankua se nuk ka kushte për shkak se nuk kishte ku të vendoste dosjen e lëndës, të cilën u detyrua ta mbajë në dorë.

---

50 Kryetar i trupit gjyqësor Gëzim Pozhegu, anëtarët Ilir Rashkaj dhe Manduhije Sylja, të akuzuarit Nikollë Shyti me avokat Ndrec Dodaj dhe Pren Shyti me avokat Meshari Selimaj, të dëmtuar File dhe Jozef Ndrecaj me përfaqësues avokat Avdi Rizvanolli.

51 Gjykatësi individual Shashivar Hoti, prokurori Abdurrahim Islami, i akuzuari Enver Hasani me avokat Bajram Tmava.

52 Kryetar i trupit gjyqësor; Shadije Gerguri, prokurori; Agron Bajram, të akuzuarit; Ferid Agani, Gani Shabani, Ali Hocalogu, Astrit Bakiqi, Borche Petrovski, Lulzim Brovina, Gani Bajraktari, Nexhmi Zegjiri, Daut Gorani, Elfedin Muhaxheri, Reshat Emra, Bedri Zaiti, Hamza Selmani, Ismail Avdimetaj, Afërdita Selmanaj, Sali Shala, Nehat Rexhepaj, Agron Besimi, Petrit Ademaj, Bajram Meziu, Agron Leka, Driton Miftari, Masar Gashi, Besim Guda, Mirdi Strana, Shemsedin Shabollari, Fisnik Hima, Luan Pazhari, Ferid Susuri, Galia Berisha, Bajram Prefeni, Arton Beqiri, Driton Sylejmani, Abdullah Tuna, Mahmut Çakmak, Shpend Elezi, Blerim Zuna, Lulzim Kamberi, Sami Gjoka, Faik Shatri, Ejup PLLana, Florim Sadiku, Halim Halili, Agim Krasniqi, Hajdin Qitaku, Afrim Bekteshi, Edmond Haliti, Besnik Koliqi, Afrim Poniku, Ferihane Sefa, Banush Gashi, Nebih Musliu, Dardan Koqinaj, Xhevdet Krasniqi, Lazer Prekpalaj, Murat Abazi, Rexhep Manaj, Raif Qavolli, Kelmend Pallaksa, Arlind Batali.

53 Kryetari i trupit gjyqësor; Xheladin Osmani, prokurori; Merita Binaj- Rugova, të akuzuarit; Tunë, Kastriot, Gjon, Marjan, Gjekson e Gëzim Kqira, Benson Buza, Besfort Omaj, Zyrafete Hukolli, Ragip Fazlija, Ekrem Leci, Hil Kaqinari, Sejdë Kaqorraj dhe Zef Oroshi.



## PROBLEME TEKNIKE

### Mos- fillimi i gjykimit me kohë

Më 29 qershor 2016, në Gjykatën Themelore të Prishtinës- Departamenti i Krimeve të Rënda, në rastin me numër të lëndës P.nr.362/14, për shkak të veprës penale Ushtrimi i ndikimit nga neni 345 paragrafi 1 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, pas disa orë pritjesh seanca gjyqësore nuk u mbajt fare dhe e njëjta u shty.

Kjo seancë gjyqësore ishte planifikuar që të fillojë nga ora 10:00 por në këtë kohë në Gjykatë u paraqitën vetëm i akuzuari me mbrojtësin e tij dhe të dëmtuarit. Rreth orës 11:00, kryetari i trupit gjykues të këtij rasti duke shfrytëzuar pauzën e një rasti tjetër (me numër të lëndës Pkr.nr.344/15) doli në korridor dhe i njoftoi palët se seanca do të shtyhet për në orën 13:30.

Seanca filloi në ora 13:35 por aty ishte i pranishëm vetëm kryetari i trupit gjykues Arben Hoti, ndërsa munguan dy anëtarët tjerë, Afërdita Bytyqi dhe Elmaz Zenuni, si dhe prokurori. Kryetari i trupit gjykues shkurtimisht e dha njoftimin se në mungesë të prokurorores nuk janë plotësuar kushtet për të mbajtur shqyrtimin gjyqësor dhe pas tri orë e gjysmë pritjesh seanca u shty që të mbahet për datën 28 korrik 2016<sup>54</sup>.

Ndërsa në [Gjykatën Themelore të Prishtinës](#), në Departamentin e Krimeve të Rënda, në rastin me numër të lëndës Pkr.135.15, për shkak të veprës penale të vrasjes nga neni 178 të KPRK-së, kishte probleme të shumta teknike.

Gjyqtari i rasti disa herë është ankuar për monitorin që e kishte larg dhe duhej të ngritej nga vendi i tij për ta përcjellë regjistrimin. Gjatë seancës gjyqësore, disa herë ka pasur shkëmbim fjalësh me tone të ngritura në mes të avokatëve Haxhi Millaku dhe Ramiz Krasniqi ndërsa gjyqtari bënte tolerime më shumë se duhej duke lejuar që në seancë gjyqësore avokatët të flisnin dhe të fjaloseshin në praninë e gjyqtarit.

Gjithashtu kjo seancë gjyqësore, është ndërprerë për disa minuta pasi që gjyqtari kishte të caktuar një seancë tjetër dhe duhej të njoftoheshin palët për mosmbajtje të seancës gjyqësore<sup>55</sup>.

Ky problem është shfaqur sidomos në sallën 17 të katit të parë, për shkak se është salla më e madhe dhe mungon monitori para trupit gjykues, ndërsa në të kaluarën ka pasur edhe në sallat tjera por tashmë janë vendosur monitorët. Problemi vazhdon të jetë prezent në sallën nr. 17 të katit të parë. Ramiz Krasniqi është njëri nga avokatët e të akuzuarve ndërsa nuk është ndërmarrë asgjë lidhur me debatet e vazhdueshme të tyre përpos një paralajmërimi verbal që nuk është konstatuar në procesverbal.

54 Trupi gjykues: Arben Hoti kryetar, Afërdita Bytyqi dhe Elmaz Zenuni anëtarë, i akuzuari Sadik Rashiti me avokat Shemsedin Pira, i dëmtuari Riad Rexhepi, Afrim Pira, Skofiare Pira e Lavdiye Ajvazi.

55 Kryetari i trupit gjykues: Faik Hoxha me anëtarët Valbona Selimi dhe Nora Bllaca, prokurori (nuk e ka shkru Labi), të akuzuarit dhe avokatët: Besim Istrefi - av. Ali Beka, Besart Istrefi - av. Haxhi Millaku dhe Jeton Saraqi -av. Ramiz Krasniqi dhe Nuhi Paqarizi, të dëmtuarit: Naim Gërvalla dhe Lutfi Saraqi. Seanca gjyqësore u mbajt me datë: 4.02.2016

## Mungesa e monitorit krijon problem për trupin gjykues

Në seancën gjyqësore të mbajtur më 14 Qershor 2016, në Departamentin e Krimeve të Rënda në Gjykatën Themelore të Prishtinës me numër të lëndës PKR.nr. 275/14, në sallën nr. 17 të katit të parë në Pallatin e Drejtësisë, për shkak të veprave penale Krim i organizuar, marrje e ryshfetit dhe keqpërdorim i detyrës zyrtare, problem paraqiti mungesa e monitorëve për gjykatës.

Mungesa e një monitori për trupin gjykues në këtë seancë paraqiti mjaft probleme pasi që kryetari i trupit gjykues disa herë i ndërpreu palët, duke u ofruar te procesmbajtësja për të shikuar se çka është duke u shkruar në procesverbal<sup>56</sup>.



“Qëllimi i këtij lloj dënimi alternativ është që kryerësit e veprave penale mos të izoloohen, mos të privohen nga liria e lëvizjes, po ashtu ky lloj dënimi përmban attribute të dënimit moral, financiar, si dhe detyrime të caktuara ndaj të dëmtuarit dhe ndaj shoqërisë, të cilat kryerësi i veprës penale duhet t'i përmbushë”

<sup>56</sup> Trupi gjykues Faik Hoxha kryetar, Valbona Selimaj dhe Nora Blaca anëtare, prokurori Abdurrahim Islami nga PSK, të akuzuarit Hasip Kiku etj, e dëmtuar ATK dhe Doganat e Kosovës.

## II. ANALIZA TË VEÇANTA; 1. DËNIMET ME PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME

Kodi Penal i Republikës së Kosovës i cili ka filluar të jetësohet në janarin e vitit 2013 parasheh si dënim alternativ edhe dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Ky lloj i dënimit është paraparë si zëvendësim i dënimit me burgim të shqiptuar deri në një vit ose i dënimit me gjobë të shqiptuar deri në 2,500 euro.

Dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme caktohet në kohëzgjatje duke filluar nga minimumi prej 30 orë deri në 240 orë pune, me kusht që kohëzgjatja e kryerjes së orëve të punës të mos jetë më e gjatë se një vit.

Puna në dobi të përgjithshme mund të kryhet në mënyrë individuale dhe në mënyrë grupore e cila ndikon dukshëm në mos përsëritjen e veprave penale nga kryerësit e tillë. Ky dënim alternativ është në interes të kryerësit të veprës penale por edhe të shoqërisë, duke pasur parasysh faktin se qëllimi prioritar është rehabilitimi i kryerësit të veprës penale. Njëri nga gjyqtarët që ka aplikuar këtë dënim në 6-7 raste gjatë vitit 2016 thotë se shihet përparësi në aplikimin e këtij dënimi.

"Qëllimi i këtij lloj dënimi alternativ është që kryerësit e veprave penale mos të izoloohen, mos të privohen nga liria e lëvizjes, po ashtu ky lloj dënimi përmban atribute të dënimit moral, financiar, si dhe detyrime të caktuara ndaj të dëmtuarit dhe ndaj shoqërisë, të cilat kryerësi i veprës penale duhet t'i përmbushë".<sup>57</sup>

Duke parë rëndësinë e aplikimit të këtij dënimi, Raporti ka siguruar të dhëna nga Gjykatat Themelore për vitin 2016.

**Tabela më poshtë pasqyron aplikimin e këtij dënimi në shtatë Gjykatat Themelore të Kosovës.**

GJYKATA	DËNIMET ME PUNË NE DOBI TË PËRGJITHSHME GJATË VITIT 2016	
FERIZAJ	73	Qëndrimi i një të dënuari në burg i kushton financiarisht buxhetit të shtetit <b>29- 30 euro në ditë</b>
PEJË	27	
GJAKOVË	0 DËNIME	
GJILAN	0 DËNIME	
PRIZREN	0 DËNIME	
PRISHTINË	NUK KA OFRUAR TË DHËNA!	
MITROVICË	NUK KA OFRUAR TË DHËNA!	
TOTAL	100	

Siç shihet nga tabela, përjashtuar Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe atë në Mitrovicë

<sup>57</sup> Sulltan Dobraj, gjykatës në Gjykatën Themelore në Pejë- dega në Deçan

të cilat nuk kanë ofruar të dhëna statistikore, për tri prej gjykatave themelore të mëdha siç është ajo e Prizrenit, Gjilanit dhe ajo e Gjakovës gjatë tërë vitit 2016 duket që nuk ka ekzistuar fare neni 60 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke mos shqiptuar asnjë dënim me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Tabela tregon që Gjykata e Ferizajt dhe ajo e Pejës dalin të jenë gjykatat e vetme që e kanë aplikuar këtë dënim.

Marrë parasysh faktin se qëndrimi i një të dënuari në burg i kushton financiarisht buxhetit të shtetit (29- 30 euro në ditë<sup>58</sup>) dhe po ashtu marrë parasysh faktorët tjerë negativë të cilët mund të ndikojnë në mos rehabilitimin e personit të dënuar për shkak të qëndrimit me persona recidivistë, Raporti ka paraqitur anët pozitive të shqiptimit të këtij dënimi si për kryesin e veprës penale, ashtu edhe për shoqërinë- përkatësisht shtetin.

Dënimet me kusht me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, nuk e izolojnë kryesin e veprës penale, nuk ia marrin lirinë e lëvizjes dhe njëherit përmbajnë në vete attribute të dënimit moral, financiar dhe detyrime të caktuara ndaj të dëmtuarit dhe shoqërisë, të cilat ai duhet t'i përmbushë. Ky lloj dënimi është paraparë si zëvendësim i dënimit me burgim apo me gjobë. Puna në dobi të përgjithshme si dënim alternativ konsiston në atë që me aktgjykim të gjykatës, kryesit të veprës penale i caktohet obligimi që brenda afatit të caktuar të kryejë punë në dobi të përgjithshme, në interes publik, p.sh., t'i pastrojë rrugët apo parqet e qytetit, të kujdeset për personat e moshuar, etj. Këto punë i kryen pa kompensim dhe nën mbikqyrjen e shërbimit sprovues.<sup>59</sup>

Duke marrë parasysh anët pozitive të aplikimit të këtij dënimi nga njëra anë dhe aplikimin në masë shumë të vogël në praktikë nga ana tjetër, BIRN dhe I/KS inkurajojnë gjykatat që në të ardhmen ta aplikojnë më shpesh këtë dënim alternativ si një mundësi e mirë për të ndikuar në rehabilitimin e kryesve të veprave të lehta penale dhe gjithashtu në uljen e shpenzimeve të buxhetit shtetëror.

58 Raporti i Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, QKRMT 2014.Fq 55.

59 Shih: <http://juridiksi.e-monsite.com/faqe/e-drejta-penale/leksione/denimet-alternative.html>

## 2. NEGOCIMI I MARRËVESHJES PËR PRANIMIN E FAJËSISË NË GJYKATAT E KOSOVËS 2015- 2016

Në Raportet e Monitorimit të Gjykatave dhe Prokurorive, gjykatat e Kosovës, gjyqtarët dhe prokurorët vazhdimisht kanë potencuar numrin e madh të lëndëve me të cilat ata ballafaqohen në punën e tyre dhe si rrjedhojë pamundësinë e tyre për të trajtuar në kohën e duhur lëndët që u ndahen ashtu siç përcaktohet me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Krahas afateve ligjore për zgjidhjen dhe trajtimin e lëndëve Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës ka paraparë edhe procedurat alternative për zgjidhjen e rasteve penale Negocimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë, është njëra nga këto procedura.

Instituti i marrëveshjes për pranimin e fajësisë është paraparë në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës për të zvogëluar numrin e lëndëve që pranohen në prokuroritë dhe gjykatat e Kosovës dhe si i tillë ofron përfitime për të gjitha palët e përfshira në procedurë, njëkohësisht përfiton edhe sistemi i drejtësisë në vend.

Neni 233 par.1 i Kodit të Procedurës Penal të Republikës së Kosovës, parasheh saktë mënyrën dhe kohën e hyrjes në marrëveshje për pranimin e fajësisë;

“Në çdo kohë para ngritjes së aktakuzës, prokurori i shtetit dhe mbrojtësi mund të negociojnë kushtet e marrëveshjes së shkruar për pranimin e fajësisë, në bazë të së cilës i pandehuri dhe prokurori i shtetit pajtohen për akuzat e përfshira në aktakuzë dhe i pandehuri pajtohet të pranojë fajësinë në shkëmbim për: 1.1. pajtimin e prokurorit të shtetit që t'i rekomandojë gjykatës dënim më të butë, por jo nën minimumin e paraparë me Ligj ose 1.2. konsiderime tjera në interes të drejtësisë, siç është lirimi nga dënimi sipas nenit 234 të këtij Kodi”.<sup>60</sup>

Kodi i Procedurës Penale, po ashtu parasheh që edhe pas ngritjes së aktakuzës dhe para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, prokurori i shtetit dhe mbrojtësi mund të negociojnë kushtet e marrëveshjes së shkruar për pranimin e fajësisë, në bazë të së cilës i pandehuri pranon fajësinë në shkëmbim të privilegjeve të lartcekura.

Iniciativën për aplikimin e këtij instituti në Kosovë mund ta marrin si i akuzuari dhe mbrojtësi i tij në njërën anë, ashtu edhe prokurori në anën tjetër. Në fund është gjithmonë gjykata ajo që vlerëson nëse marrëveshja është në përputhje me dispozitat e nenit 233 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, e cila mund ta pranojë apo refuzojë marrëveshjen.

BIRN dhe I/KS përmes kësaj analize përmbljedhëse, në vijim do të shpërfaqë se sa dhe si po aplikohet ky institut në gjykatat e Kosovës dhe cilat janë rezultatet e deritanishme për vitin 2015- 2016.

### Rastet e Negocimit të Marrëveshjes Për Pranimin e Fajësisë në Gjykatat e Kosovës

---

<sup>60</sup> Paragraf 1 ineni 233 të KPPRK-së.

Oysh në fillim të kësaj analize jemi të obliguar të përmendim faktin se përkundër përpjekjeve të BIRN dhe I/KS nuk kemi arritur t'i sigurojmë të dhënat për këtë temë nga Gjykata dhe Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe po ashtu edhe nga Gjykata dhe Prokuroria Themelore në Mitrovicë. Të dhënat nuk i ka ofruar as Gjykata Themelore e Pejës dhe ajo e Gjiilanit (por duke i pasur të dhënat e Prokurorisë Themelore të Gjiilanit mund të arrijmë në përfundim për numrin e këtyre rasteve në këtë gjykatë).

## Numri i Përgjithshëm i Rasteve Sipas Gjykatave

GJYKATAT	NUMRI I MARRËVESHJEVE
PRISHTINË	NUK KA KTHYER TË DHËNA!
PRIZREN	25
FERIZAJ	8
GJILAN	NUK KA KTHYER TË DHËNA!
MITROVICË	NUK KA KTHYER TË DHËNA!
PEJË	NUK KA KTHYER TË DHËNA!
GJAKOVË	2
TOTAL	35 MARRËVESHJE

3 marrëveshje në Departamentin e Përgjithshëm dhe 22 në Departamentin për Krime të Rënda.

Nëse shikohen vetëm të dhënat e ofruara nga gjykatat në Kosovë, atëherë mund të vërejmë një numër shumë të vogël të këtyre rasteve, madje, me përjashtim të Gjykatës Themelore në Ferizaj, asaj në Prizren dhe asaj në Gjakovë, gjykatat tjera nuk u kanë kthyer fare përgjigje monitoruesve të BIRN dhe I/KS me arsyetimin se nuk kanë ndonjë rubrikë ku evidentohen këto raste.

Nga të dhënat që i posedojnë gjykatat shihet se Gjykata Themelore në Prizren prin si gjykata me numrin më të madh të këtyre rasteve, gjithsej 25 raste, prej të cilave 3 marrëveshje në Departamentin e Përgjithshëm dhe 22 në Departamentin për Krime të Rënda.

Pas Prizrenit renditet Gjykata Themelore e Ferizajt, e cila ka ofruar të dhëna vetëm për vitin 2016 dhe sipas këtyre të dhënave nga janari 2016 deri në nëntor 2016 janë gjithsej 8 raste të negociimit të marrëveshjes së pranimit të fajësisë.

Ndërsa Gjykata Themelore e Gjakovës ka vetëm 2 marrëveshje të realizuara të pranimit të fajësisë.

Marrë parasysh numrin e madh të lëndëve të pazgjidhura në nivel vendi, i cili del të jetë mbi 417 mijë lëndë<sup>61</sup>, aplikimi në masë kaq të vogël të këtij instituti nga ana e gjykatave duket të mos i kontribuojë fare zvogëlimit të numrit të lëndëve dhe as drejtësisë në përgjithësi duke marrë parasysh përfitimet e dyanshme, si të palës ashtu edhe të vet institucionit.

61 Raporti i gjashtëmuorit të parë të vitit 2016 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

## Numri i Përgjithshëm i Rasteve Sipas Prokurorive:

PROKURORITË	NUMRI I MARRËVESHJEVE
PRISHTINË	NUK KA KTHYER TË DHËNA!
PRIZREN	110 MARRËVESHJE ME 172 PERSONA
PEJË	149 MARRËVESHJE ME 175 PERSONA
MITROVICË	NUK KA KTHYER PËRGJIGJE
GJILAN	508 MARRËVESHJE, NUK E KA NUMRIN E PERSONAVE
FERIZAJ	60 MARRËVESHJE ME 72 PERSONA
GJAKOVË	76 MARRËVESHJE ME 89 PERSONA
TOTAL	903 MARRËVESHJE

Prokuroria e kryeqytetit të Kosovës, Prishtinës, dhe ajo e Mitrovicës nuk kanë kthyer ndonjë përgjigje lidhur me lëndët e kësaj natyre. Ata për më tepër nuk janë përgjigjur fare në pyetjet e BIRN dhe I/KS duke e injoruar në tërësi pyetjet tona.

Siç mund të shihet edhe nga të dhënat e siguruara, Prokuroria e Gjilanit është lidere e padiskutueshme në zgjidhjen e rasteve me negociim të marrëveshjes për pranim të fajësisë, me 508 marrëveshje, mirëpo për numrin e personave të përfshira në këto marrëveshje kjo prokurori nuk ka të dhëna.

Menjëherë pas kësaj prokurorie renditet ajo e Pejës me 149 marrëveshje me 175 persona të përfshirë ndërsa vijon me Prokurorinë e Prizrenit me 110 marrëveshje dhe me 172 persona të përfshirë, ajo e Gjakovës me 76 raste dhe 89 persona të përfshirë në këto marrëveshje dhe Prokuroria në Ferizaj që e mbyll renditjen me 60 raste dhe 72 persona të përfshirë në marrëveshjen për pranim të fajësisë.

Duke mos i përfshirë të dhënat e prokurorisë së Prishtinës dhe Mitrovicës, prokuroritë në total kanë zgjidhur 903 raste me marrëveshje për pranimin e fajësisë, numër jo i vogël në kontributin e ekonomizimit dhe zvogëlimit të numrit të lëndëve në përgjithësi.

“Prokuroria Themelore në Gjilan, ka arritur ta ketë numrin më të madh të lëndëve të kryera me institutin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, për faktin se qysh në vitin 2013 kemi bërë një strategji për kryerjen e lëndëve përmes procedurave alternative, sidomos përmes institutit të marrëveshjes, ashtu që qysh në vitin 2013 kemi realizuar përmes këtyre instituteve mbi 7% të lëndëve të kryera përmes procedurave alternative, pastaj në vitin 2014 aty mbi 10% të lëndëve, në vitin 2015 rreth 22% ndërsa në vitet e ardhshme pretendojmë të shkojmë deri në mbi 50% të lëndëve nga numri i përgjithshëm. Sugjeroj prokuroritë tjera në nivel vendi që t'i përkushtohen shumë më shumë këtyre instituteve, sepse përvoja në prokurorinë dhe gjykatën tonë në Gjilan ka treguar suksesin e tyre duke zvogëluar numrin e madh të lëndëve dhe stërzgjatjen e panevojshme të procedurave gjyqësore deri në vendosjen meritore të lëndëve”.<sup>62</sup>

62 Intervista me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore të Gjilanit, z.Jetish Maloku.

Arritja e marrëveshjes për pranim të fajësisë në fazën e hetimit sjell përfitime të gjithanshme për të gjitha palët e përfshira në procedurën penale. Së pari prokuroria lirohet nga përfaqësimi i lëndës duke mos pasur nevojë të ngrisë aktakuzë dhe ta mbrojë atë aktakuzë në shqyrtim gjyqësor. Në anën tjetër i dyshuari përfiton duke arritur marrëveshje në një fazë më të hershme të procedurës e që reflekton në lartësinë e dënimit të shqiptuar. Në anën tjetër edhe gjykata e ka përfitimin e saj sepse eviton rrezikun e mbingarkesës me lëndë penale dhe realizon numër më të madh të lëndëve të zgjidhura.

Duke pasur parasysh faktin se Kodi i Procedurës Penal i Republikës së Kosovës e njet të drejtën e gjykatës që zyrtarisht ta pranojë apo refuzojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë- po ashtu marrëveshja mbi pranimin e fajësisë duhet të jetë e nënshkruar edhe nga kryeprokurori i zyrës përkatëse- BIRN dhe I/KS kanë bërë krahasimin e rasteve në të cilat është refuzuar marrëveshja mbi pranimin e fajësisë.

**Në vijim paraqitet tabela me numrin e rasteve kur është refuzuar marrëveshja për pranimin e fajësisë nga prokuroria dhe nga gjykata.**

QYTETI	REFUZIMI I MARRËVESHJEVE NGA PROKURORIA	PROPOZIM MARRËVESHJET E PROKURORISË TË REFUZUARA NGA GJYKATA
PRISHTINË	NUK KA TË DHËNA!	NUK KA TË DHËNA!
PRIZREN	1 RAST	0 RASTE
PEJË	0 RASTE	1 RAST
MITROVICË	NUK KA TË DHËNA!	NUK KA TË DHËNA!
GJILAN	0 RASTE	0 RASTE
FERIZAJ	0 RASTE	0 RASTE
GJAKOVË	0 RASTE	0 RASTE

Nga numri total i këtyre rasteve të zgjidhura me këtë institut, vetëm dy raste janë refuzuar



Nga të dhënat e paraqitura në formë tabelare më lartë shihet se gjykatat dhe prokuroritë në Kosovë kanë luajtur një rol pozitiv në rastet e negociimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Nga numri total i këtyre rasteve të zgjidhura me këtë institut, vetëm dy raste janë refuzuar, njëri nga Gjykata në Pejë (nuk jepen arsyet e refuzimit) dhe një rast tjetër nga Prokuroria në Prizren (në këtë rast që mban numrin e lëndës PP.nr.152/16, mbrojtësi i të akuzuarit ka parashtruar kërkesën për negociim të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, por kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Prizrenit nuk e ka pranuar negociimin duke pasur parasysh se bëhej fjalë për sasinë e narkotikëve të llojit marihuana prej 10.3 kg dhe se i akuzuari nuk ka bashkëpunuar dhe nuk ka qenë i gatshëm të tregojë se cili ka qenë destinacioni i narkotikëve të përmendur). Në këtë çështje pas zhvillimit të procesit gjyqësor Gjykata e ka gjetur fajtor të akuzuarin dhe i ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumën prej 1,000 Euro dhe dënimin me burg efektiv në kohëzgjatje prej 2 vjet e 6 muaj.

Raporti vlerëson rolin pozitiv të prokurorisë dhe gjykatës në këtë segment të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, duke u bazuar në të dhënat e siguruara nga këto institucione në të cilat shihet se janë vetëm dy raste ku ka dështuar propozim marrëveshja e lidhur ndërmjet prokurorisë dhe palës.

## Përfundim

Me 903 raste të përfshira në marrëveshjen e pranimi të fajësisë për një periudhë dyvjeçare (pa i pasur këtu të dhënat e Gjykatës Themelore të Prishtinës si gjykata me numrin më të madh të lëndëve në vend, Gjykatës Themelore të Mitrovicës dhe Prokurorisë Themelore të Prishtinës dhe asaj të Mitrovicës), mund të konstatojmë se ky institut i procedurës penale meriton një trajtim dhe përdorim më të madh në Kosovë, veçanërisht duke ditur numrin e madh të lëndëve me të cilat përballen prokuroritë dhe gjykatat tona.

Ky numër i lëndëve krahasuar me numrin total të lëndëve të pazgjidhura në Kosovë, e që sipas raportit të gjashtëmujorit të parë të vitit 2016 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës është 417,733 lëndë, vërtetë është një numër simbolik, por që paraqitet si një mundësi e mirë për zvogëlimin e numrit të madh të lëndëve.

Konsiderojmë se gjykatat dhe veçanërisht prokuroritë tona duhet të jenë më të hapura ndaj këtij instituti në kuptimin që të gjejë vend më shpesh në praktikën tonë gjyqësore, duke shfrytëzuar hapësirën ligjore që mundëson Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, që parasheh mundësinë që prokurori të ndërmarrë iniciativën për zbatimin e këtij instituti.

Raporti konsideron se zbatimi më i shpeshtë i kësaj marrëveshjeje për pranim të fajësisë, do të ishte një burim i përfitimeve për të gjitha palët në procedurë, duke përfshirë këtu ekonomizimin dhe zvogëlimin e numrit të lëndëve në përgjithësi.

### 3. NDËRMJETËSIMI SI FORMË ALTERNATIVE E ZGJIDHJES SË LËNDËVE NË GJYQËSOR

Njëra ndër format alternative për zgjidhjen e lëndëve është edhe procedura e ndërmjetësimit, e cila aplikohet për veprat penale të dënueshme me gjobë ose burg deri në tri vjet. Për raste të tilla prokurori i shtetit mund ta dërgojë lëndën te ndërmjetësuasi i pavarur për ndërmjetësim, i cili pastaj mund të arrihet me pëlqimin e të pandehurit dhe të dëmtuarit.

Në Kosovë ndërmjetësimi është rregulluar me ligjin për ndërmjetësim të vitit 2008<sup>63</sup>.

Sipas Ligjit, "Ndërmjetësimi" përkufizohet si veprimtari jashtëgjyqësore që realizohet nga një person i tretë (ndërmjetësi), për zgjidhje të mosmarrëveshjeve ndërmjet subjekteve të së drejtës në pajtim me kushtet e parashikuara në këtë ligj.<sup>64</sup>

Ndërmjetësimi, ashtu siç është përkufizuar në Ligjin e Kosovës për ndërmjetësimin, është ndërmjetësim lehtësues.

Përveç prokurorit lëndën në ndërmjetësim mund ta dërgojë edhe gjyqtari në cilën do fazë po që se pajtohen palët që lëndën ta kryejnë nëpërmes negocimit.

Duke u bazuar në kompetencat ligjore të garantuara me ligj, BIRN dhe I/KS kanë siguruar statistikave nga prokuroritë dhe gjykatat për lëndët e dërguara dhe të zgjidhura përmes ndërmjetësimit.

#### Ndërmjetësimi sipas statistikave 2015- 2016

BIRN dhe I/KS kanë siguruar të dhëna statistikore për rastet e ndërmjetësimit nga prokuroritë, gjykatat dhe Ministria e Drejtësisë.

Sipas të dhënave të siguruara, disa gjykata dhe prokurori nuk kanë kthyer fare përgjigje me arsyetimin se nuk kanë të dhëna statistikore të tilla.

Duke pasur në dispozicion të dhëna të mangëta të ofruara nga gjykatat dhe prokuroritë themelore dhe pa mundësimin e një analize të mirëfilltë me statistikave të ofruara në dispozicion, BIRN dhe I/KS kanë siguruar të dhëna për procedurën e ndërmjetësimit edhe nga Ministria e Drejtësisë për vitin 2015- 2016.

Shtatë regjionet për të cilat Ministria e Drejtësisë ka publikuar statistikave për rastet e ndërmjetësimit janë: Prishtina, Ferizaj, Gjakova, Peja, Gjitani, Mitrovica dhe Prizreni.

Këto statistika të Publikuara në Ministrinë e Drejtësisë tregojnë edhe nga cili institucion janë referuar për ndërmjetësim nga Gjykata, Prokurori, si dhe rastet me vetëreferim të palëve. Gjithashtu, këto statistika tregojnë edhe numrin e zgjidhjes së rasteve të referuara

63 Ligji Nr. 03/ L-057, 18 Shtator 2008

64 [http://www.gazetazryftare.com/e-gov/index.php?option=com\\_content&task=view&id=276&Itemid=28](http://www.gazetazryftare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=276&Itemid=28)

për ndërmjetësim si dhe sa raste kanë mbetur të pa zgjidhura gjatë kësaj periudhe.

Tabelat më poshtë paraqesin të dhënat statistikore për rastet e ndërmjetësimit për vitet 2015- 2016 të siguruara nga Ministria e Drejtësisë. Edhe pse në të dhënat e prezantuara shihet se ka mos përputhje në shifra, të cilat sipas Ministrisë së Drejtësisë kanë ndodhur për shkak të bartjes së rasteve nga një vit kalendarik në vitin tjetër. Shpjegim tjetër sipas Ministrisë është fakti se jo të gjitha rastet e referuara arrijnë të hyjnë në proces të ndërmjetësimit.

“Për shembull, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Prizren janë referuar rastet të cilat janë publikuar dhe të gjitha ato nuk kanë arritur të hyjnë në proces te ndërmjetësimit sepse rastet e referuara janë selektuar nga projekti CLE/USAID të cilët kanë konstatuar se nuk janë të përshtatshme për ndërmjetësim dhe janë kthyer pa hyrë në procedurën e ndërmjetësimit”. Saranda Salihu, Ministria e Drejtësisë.

**Tabela me rastet e ndërmjetësimit për vitin 2015**

NUMRI TOTAL 2015	PRISHTINË	FERIZAJ	GJAKOVË	PEJË	GJILAN	MITROVICË	PRIZREN	TOTAL
Raste të referuara nga Gjykata	<b>164</b>	<b>18</b>	<b>28</b>	<b>98</b>	<b>203</b>	<b>36</b>	<b>94</b>	<b>641</b>
Raste të referuara nga Prokuroria	<b>267</b>	<b>102</b>	<b>129</b>	<b>56</b>	<b>16</b>	<b>77</b>	<b>122</b>	<b>769</b>
Raste me vetë-referim	<b>3</b>		<b>3</b>	<b>4</b>	<b>18</b>	<b>73</b>	<b>3</b>	<b>104</b>
Të referuara gjithsej për Ndërmjetësim	<b>434</b>	<b>120</b>	<b>160</b>	<b>158</b>	<b>238</b>	<b>182</b>	<b>219</b>	<b>1511</b>
Të zgjidhura gjithsej	<b>515</b>	<b>103</b>	<b>129</b>	<b>139</b>	<b>213</b>	<b>165</b>	<b>18</b>	<b>1282</b>
Të pazgjidhura gjithsej	<b>11</b>	<b>6</b>	<b>19</b>	<b>40</b>	<b>7</b>	<b>20</b>	<b>15</b>	<b>118</b>
Në proces (shifra e totalit varion)		<b>12</b>	<b>17</b>	<b>8</b>	<b>4</b>	<b>10</b>	<b>6</b>	<b>57</b>

**Tabela me rastet e ndërmjetësimit për vitin 2016**

NUMRI TOTAL JANAR - GUSHT 2016	PRISHTINË	FERIZAJ	GJAKOVË	PEJË	GJILAN	MITROVICË	PRIZREN	TOTAL
Raste të referuara nga Gjykata	239	3	46	26	108	22	1	445
Raste të referuara nga Prokuroria	306	71	97	5	27	54	18	578
Raste me vetë-referim	3	1	1		6	23	1	35
Të referuara gjithsej për Ndërmjetësim	548	75	144	31	141	99	20	1058
Të zgjidhura gjithsej	386	60	116	30	129	90	13	824
Të pazgjidhura gjithsej	8	1	15	5	9	8	2	48

Sipas statistikave të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2015, me rastet që janë referuar prin Gjykata e Gjilanit me gjithsej 203 raste, ndërsa për vitin 2016 këtë primat e ka Gjykata e Prishtinës me 239 raste. Në vitin 2015 më së paku raste që janë referuar nga gjykata është ajo e Ferizajt me 18 raste, ndërsa për vitin 2016 që më së paku raste ka referuar është gjykata e Prizrenit me vetëm 1 rast.

Po ashtu sipas statistikave të MD-së prej prokurorive që kanë referuar më së shumti raste në vitin 2015 është prokuroria e Prishtinës me 267 raste, ndërsa më së paku raste të referuara në këtë vit prej prokurorive është ajo e Gjilanit me vetëm 16 raste. Ndërsa për vitin 2016 sërish Prokuroria e Prishtinës është prokuroria që ka referuar më së shumti me gjithsej 306 raste ndërsa në këtë vit prokuroria që më së paku ka referuar raste është ajo e Pejës me vetëm 5 raste.

Po ashtu këto statistika tregojnë se në vitin 2015 rastet që janë referuar me vetë referim më së shumti ka rajoni i Mitrovicës me gjithsej 73 raste, kurse Prishtina, Gjakova dhe Prizreni kanë vetëm nga 3 raste me vetëreferim. Po ashtu edhe në vitin 2016 me vetë referim të rasteve prinë rajoni i Mitrovicës me 23 raste, ndërsa me nga një rast janë Ferizaj, Gjakova dhe Prizreni.

Gjithnjë sipas këtyre statistikave, më së shumti raste të zgjidhura me procedurën e ndërmjetësimit në të dy vitet 2015-2016 ka Prishtina me gjithsej 515 raste përkatësisht 386 raste. Ndërsa këto statistika tregojnë se më së paku raste të zgjidhura me ndërmjetësim për vitin 2015 dhe 2016 është Prizreni me vetëm 18 raste për vitin 2015, ndërsa në vitin 2016 me vetëm 13 raste të zgjidhura.

## Problemet që i kanë hasur ndërmjetësuesit nga fillimi i punës së tyre

Ndërmjetësimi në Kosovë është rregulluar me ligj në vitin 2008, por zbatimi i këtij ligji ka filluar të zbatohet në vitin 2011, kur edhe janë licencuar ndërmjetësuesit e parë.

Si çdo profesion tjetër, edhe ndërmjetësimi ka hasur në probleme e sfida të ndryshme për të cilat kanë folur edhe vetë ndërmjetësuesit.

Një nga sfidat që ndërmjetësimi ka hasur është edhe ai i financimit të qendrave të ndërmjetësimit në regjionet e Kosovës. Qendrat e ndërmjetësimit janë financuar nga projektet e donatorëve të jashtëm nëpërmjet projekteve të ndryshme pasi që kishin nënshkruar marrëveshje me Ministrin e Drejtësisë.

Nga fillimi i vitit 2016 është shfaqur si sfidë financimi i qendrave të ndërmjetësimit në regjionet e Kosovës, pasi që donatorët i kanë përfunduar projektet e tyre dhe pas përfundimit të këtyre projekteve disa nga qendrat janë mbyllur. Financimi i qendrave të ndërmjetësimit është bërë nga projektet e donatorëve për tri qendra, ajo në Pejë, Prizren dhe Gjilan. Pasi ka përfunduar projekti më 1 maj 2016, ato janë mbyllur.

Ministria e Drejtësisë nuk ka dhënë shpjegime lidhur me marrëveshjen dhe atë se si ka qenë e përcaktuar të jetë financimi pas përfundimit të marrëveshjes me donatorët.



“Prokurorët dhe gjyqtarët nuk po referojnë mjaftueshëm aq sa kanë lëndë për ndërmjetësim, por në Prishtinë momentalisht nuk kemi kapacitete humane edhe logjistike të menaxhohme me më shumë lëndë se që tani procedohen në këtë qendër të ndërmjetësimit”.

Ndërsa Chris Thompson nga USAID/CLE Contract Law Enforcement për BIRN dhe I/KS tha se USAID i ka përkrahur qendrat e Ndërmjetësimit në Prizren, Pejë dhe Gjilan nga viti 2011 deri në vitin 2016. Mbështetja është bërë në koordinim me Ministrinë e Drejtësisë dhe nuk ka pasur ndonjë marrëveshje apo memorandum sepse nuk e ka kërkuar ligji një gjë të tillë.

Për mbylljen e qendrës së ndërmjetësimit në Prizren, është ankuar kryeprokurori i Prokurorisë së kësaj komune.

“Nuk kemi qenë të kënaqur me Zyrën për Ndërmjetësim këtu në Prizren, kjo zyre nuk ka funksionuar sa duhet, kjo po shihet nga rastet e dorëzuara për ndërmjetësim, në realitet i kanë kryer shumë pak raste. Tani kjo zyre për ndërmjetësim është mbyllur, jemi në kontakte me zyrën Qendrore në Prishtinë dhe presim që të aktivizohet puna e kësaj zyre sepse do të na ndihmonte mjaft”.<sup>65</sup>

Nga sekretariati për ndërmjetësim thonë se gjyqtarët dhe prokurorët nuk po referojnë lëndët e tyre mjaftueshëm në procedurën e ndërmjetësimit.

“Prokurorët dhe gjyqtarët nuk po referojnë mjaftueshëm aq sa kanë lëndë për ndërmjetësim, por në Prishtinë momentalisht nuk kemi kapacitete humane edhe logjistike të menaxhohme me më shumë lëndë se që tani procedohen në këtë qendër të ndërmjetësimit”<sup>66</sup>.

Nga Ministria e Drejtësisë nuk kanë dhënë përgjigje lidhur me kapacitetet e tyre por kanë thënë se ka pasur rritje të rasteve të referuara në ndërmjetësim, e si pasojë e kësaj është paraqitur nevoja për rritjen e stafit në qendrën e ndërmjetësimit në Prishtinë e gjithashtu edhe për hapësirë shtesë.

<sup>65</sup> SylëHoxha- kryeprokuroriProkurorisëThemelorenëPrizren  
<sup>66</sup> Vjosa Shehu, zyrtare ligjore në sekretariatën për Ndërmjetësim.

Sipas statistikave të përgjithshme, 4801 raste janë gjithsej të referuara ndërsa 3786 prej tyre janë zgjidhur përmes procedurës së ndërmjetësimit. Pra nëse llogarisim me përqindje i bie që rreth 80 përqind të rasteve të referuara janë zgjidhur me ndërmjetësim.

Financimi i qendrave të ndërmjetësimit sipas përgjigjeve të Ministrisë së Drejtësisë ka mbetur i pazhvilluar dhe i varur nga projektet e organizatave ndërkombëtare por shpresohet që me ligjin e ri për ndërmjetësim i cili është në procedurë të amendamentimit të krijohet një bazë ligjore dhe financiare për ndërmjetësimin.

Për sfidat dhe problemet që i hasin gjatë zhvillimit të procedurave të ndërmjetësimit kanë treguar vetë ndërmjetësuesit.

Ndërmjetësuesja Ganimete Xhelili nga rajoni i Gjilani për problemet që janë paraqitur pas mbylljes së qendrës së ndërmjetësimit në Gjilan tha se Qendra gjatë kohës sa ka qenë duke funksionuar, ka pasur rregull por është ankuar se nuk ka pasur shumë referime të lëndëve në ndërmjetësim nga gjyqtarët dhe prokurorët.

“Mendoj se qendra ka funksionuar deri diku në rregull pavarësisht që nuk referohen edhe shumë raste të ndërmjetësimit prej gjyqtarëve dhe prokurorëve pasi që ka qenë një radhitje e ndërmjetësuesve. Pas mbylljes së zyrës unë kam pasur vetëm dy raste të ndërmjetësimit”, tha Xhelili.

Ndërmjetësuesja Xhelili kërkon që qendra e ndërmjetësimit të fillojë punën sërish në Gjilan dhe të ketë financim të vazhdueshëm. Ndërsa ndërmjetësuesi tjetër Faton Morina nga Prishtina thotë se ka shumë lëndë që nuk do të duhej të prisnin me vite nga gjykatat për t’u referuar në ndërmjetësim.

“Ajo çka duhet të bëhet më shumë është të eliminohet hezitimi që lëndët të cilat mund të referohen në ndërmjetësim mos të rrinë një kohë të gjatë nëpër gjykata por ato le t’u ofrohen palëve si mundësi e zgjidhjes alternative”.

## Përfundim

Raporti konsideron se ndërmjetësimi si formë alternative e zgjidhjes së lëndëve në gjykata dhe prokurori duke u bazuar në statistika<sup>67</sup> ka kontribuar minimalisht në zgjidhjen dhe zvogëlimin e numrit të lëndëve në gjykata dhe prokurori.

Për mosefikasitetin e duhur të kësaj forme alternative të zgjidhjes së lëndëve kanë kontribuar disa faktorë, ndër të cilët mosvetëdijësimi i qytetarëve që të kërkojnë që lëndët e tyre të zgjidhen përmes ndërmjetësimit pasi që kjo formë është më e shpejtë, më e lirë dhe mbi të gjitha përfitim kryesor ka edhe faktin se të pandehurin e tërheqë nga lista e kryesve të veprave penale pasi që pushohen hetimet ose tërhiqet aktakuza dhe rasti mbyllet.

Faktor tjetër me rëndësi që ndërmjetësimi nuk ka kontribuar në masën e duhur në zvogëlimin e lëndëve është edhe ngurrimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve që këto raste t’i dërgojnë në ndërmjetësim.



“Ajo çka duhet të bëhet më shumë është të eliminohet hezitimi që lëndët të cilat mund të referohen në ndërmjetësim mos të rrinë një kohë të gjatë nëpër gjykata por ato le t’u ofrohen palëve si mundësi e zgjidhjes alternative”

**GANIMETE XHELILI,  
NDËRMJETËSUESE**

67 Shih tabelat me rastet e viteve 2015- 2016 faqe 47 dhe 48

“Kërkoj edhe ndihmën e ‘Drejtësia në Kosovë’ për ta promovuar ndërmjetësimin si alternative para se palët t’i drejtohen gjykatës”.

Afërdita Bytyqi – Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë

Si faktor tjetër paraqitet edhe mos zgjidhja e financimit të përhershëm për qendrat e ndërmjetësimit dhe lënia e tyre në dorën e donatorëve, përderisa Raporti konsideron se një gjë e fillë do të kishte mundur të bëhet nga vetë institucionet shtetërore.

Raporti i rekomandon Ministrisë së Drejtësisë që gjatë plotësimit ndryshimit të Ligjit për Ndërmjetësim të ketë parasysht që të zgjedhë formën e financimit të qendrave të ndërmjetësimit në regjionet e Kosovës. Po ashtu të bëhet fushatë vetëdijesuese për qytetarët që lëndët e tyre t’i zgjidhin përmes kësaj procedure alternative.

Raporti, duke parë numrin e vogël të rasteve të zgjidhura përmes ndërmjetësimit, inkurajon prokurorët, gjyqtarët dhe qytetarët që lëndët e tyre t’i dërgojnë për zgjidhje në procedurë të ndërmjetësimit.

## 4. HEDHJA E AKTAKUZËS NË SHQYRTIMIN E DYTË

Me hyrjen në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, nga janari i vitit 2013 u paraqitën ndryshime edhe në fazën fillestare të procedurës penale.

Faza e procedurës së konfirmimit të aktakuzës u zëvendësua me shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë gjyqësor, fazë kjo në të cilën paraqiten kundërshtimet për provat e cekura në aktakuzë dhe ajo që është më e rëndësishmja në këtë fazë para mbajtjes së shqyrtimit të dytë, paraqiten kërkesat për hedhjen e aktakuzës nëse është e ndaluar ligjërisht apo për shkak të mospërshkrimit të veprës penale sipas ligjit.

Nga praktika duket qartë se tradita e mos hedhjes së aktakuzave edhe në rastet kur nuk ka prova të mjaftueshme po vazhdon me të vjetrën, ashtu siç ka ndodhur me fazën e procedurës për konfirmimin e aktakuzës dhe si është e përshkruar në vijim.<sup>68</sup>

Pavarësisht faktit që Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës i jep autorizim gjyqtarit individual apo kryetarit të trupit gjykues për hedhjen e aktakuzës në shqyrtimin e dytë<sup>69</sup>, ajo që BIRN dhe I/KS kanë vërejtur gjatë procesit të monitorimit të gjykatave në vitin 2016 është se kjo fazë e procedurës është shndërruar në fazë e cila shërben veçse për ta kënaqur procedurën.<sup>70</sup>

Të gjeturat tona tregojnë se Gjykatat Themelore të Kosovës edhe në rastet kur aktakuza nuk i përmbushë as kriteret themelore për të kaluar në fazën e shqyrtimit gjyqësor, ato shumë rrallë aplikojnë hedhjen e aktakuzave ashtu siç ua ka garantuar ligji këtë të drejtë në nenin 253 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës<sup>71</sup>.

Për ta bërë më të lehtë krahasimin e mos'hedhjes së aktakuzave të pa baza, Raporti ka bërë krahasimin e numrit të vendimeve të gjykatave të Kosovës për hedhjen e aktakuzave dhe numrin e aktgjytimeve liruese në mungesë të provave. Si indikator i veçantë në mos hedhjen e aktakuzave në shqyrtim të dytë, nga neni 253 të Kodit të Procedurës Penale, në bazë të intervistave të BIRN dhe I/KS të realizuar me gjykatës, del të jetë mosguximi i gjyqtarëve në aplikimin optimal të dispozitave të procedurës, nga frika e ballafaqimit me ndonjë kallëzim penal të mundshëm. Pohimet e tilla janë marrë nga vet gjykatësit me të cilët janë zhvilluar intervistat dhe të cilët kanë preferuar të mbesin anonim.

Nevojën për përshpejtim të procedurës dhe pengim të çdo keqpërdorimi nga pjesëmarrësit proceduralë dhe për një proces të rregullt gjyqësor, e parasheh edhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, ku mes tjerash thuhet.<sup>72</sup>

68 Shih tabelën fq.72

69 Shih neni 253 i KPPRK-së/

70 Shih tabelën faqe 72

71 Shih tabelën faqe 72

72 KEDNj, Neni 6 par. 1



“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij”.

Edhe Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës shprehet qartë për një gjykim të drejtë, të paanshëm dhe në afat të arsyeshëm, sipas të cilit çdo person i dyshuar ose i akuzuar për veprë penale ka të drejtë të kërkojë procedurë të paanshme penale të zbatuar në kohë të arsyeshme.<sup>73</sup>

Seanca e shqyrtimit të dytë para hyrjes në shqyrtim gjyqësor ka të bëjë pikërisht me kundërshtimin e provave dhe hedhjen e aktakuzës. Është kjo fazë e cila me aplikimin optimal të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale pamundëson keqpërdorimin nga organet e ndjekjes në ngritje të akuzave pa bazë të mjaftueshme dhe manipulim të ndjekjes penale.

Nga monitorimi i BIRN dhe I/KS është vërejtur se faza e shqyrtimit të dytë është shndërruar në aplikim formal sa për ta kënaqur procedurën. Nga ana tjetër, mosaplikimi korrekt i kësaj faze të procedurës ndikon drejtpërdrejt në ekonomizim të një rasti gjyqësor dhe në shpenzime procedurale.

Mbajtja dhe procedimi i gjykimeve nëpër të gjitha fazat pa pasur prova të mjaftueshme përveç që ndikon në shpenzime të mëdha procedurale të cilat në fund paguhen nga buxheti i Republikës së Kosovës, ndikon edhe në shkeljen e të drejtave të njeriut dhe gjithashtu ndikon në numrin e madh të lëndëve të grumbulluara në gjykatë.

## **Të Gjeturat Nga Gjykatat Themelore**

Raporti ka mbledhur të dhëna nga Gjykatat Themelore në Kosovë për vitin 2016 lidhur me rastet që kanë të bëjnë me hedhje të aktakuzës dhe kanë bërë krahasimin me aktgjykimet liruese të marra nga këto gjykata, të cilët kanë qenë kryesisht për shkak të mungesës së provave.

---

73 Neni 5 par.1 i KPPRK-së

**Tabela me numrin e rasteve të aktakuzave të hudhura nga neni 253 dhe aktgjykimeve liruese në mungesë të provave:**

GJYKATA THEMELORE:	HUDHJA E AKTAKUZAVE NGA NENI 253 TË KPPK-SË	AKTGJYKIMET LIRUESE NË MUNGESË TË PROVAVE
PRIZREN	4	14
GJAKOVË	1	30
DEGA MALISHEVË	0	7
DEGA RAHOVEC	0	?
PRISHTINË	?	?
FERIZAJ	8	19
GJILAN	2	48
MITROVICË	?	?
PEJË	?	?
DEGA KLINË	5	1
DEGA ISTOG	1	1
TOTAL	20	120

“Këtu Gjykata e Apelit në fillim ka pasur një qëndrim krejt tjetër. Kohëve të fundit e ka ndërruar qëndrimin dhe besoj që jemi në rrugë të mbarë për t’i hedhure dhe në këtë fazë. Apeli kryesisht vendimet i merrte në atë drejtim që të hyhet në shqyrtim gjyqësor, tash e kanë vërejtur që është mire të hedhen edhe në këtë fazë”.

Ymer Hoxha – Kryetar i Gjykatës Themelore në Prizren

-Në Gjykatën Themelore në Prizren nga janari i vitit 2016 në bazë të nenit 253 të KPPRK-së janë hedhur gjithsej 4 aktakuzat në shqyrtimin e dytë, duke qenë se këtë vit janë shpallur 36 aktgjykime liruese. Nga këto aktgjykime liruese, 14 kanë qenë në mungesë të provave.

-Në Gjykatën Themelore në Gjakovë nga janari i vitit 2016 në bazë të nenit 253 të KPPRK-së është hedhur një aktakuzë, duke qenë se këtë vit janë shpallur 30 aktgjykime liruese dhe të gjitha këto në mungesë të provave. Nga 30 aktgjykimet liruese, 20 janë të plotfuqishme.

-Në Gjykatën Themelore në Gjakovë- dega Malishevë nga janari i vitit 2016 në bazë të nenit 253 të KPPK-së nuk është hedhur asnjë aktakuzë, duke qenë se këtë vit janë shpallur 7 aktgjykime liruese të gjitha në mungesë të provave.

-Në Gjykatën Themelore në Pejë nuk i janë përgjigjur pyetjeve për këtë temë.

-Në Gjykatën Themelore në Pejë – dega Klinë nga janari i vitit 2016 në bazë të nenit 253 të KPPRK-së janë hedhur gjithsej 5 aktakuzat në shqyrtimin e dytë, duke qenë se kjo gjykatë nuk ka ofruar informacione lidhur me aktgjykimet liruese në mungesë të provave.

-Në Gjykatën Themelore në Prishtinë nuk na janë ofruar të dhëna me arsyetimin se kjo gjykatë nuk mban evidencë të veçantë lidhur me këtë temë!

-Në Gjykatën Themelore në Ferizaj bashkë me degët e saj Kaçanik dhe Shtërpcë nga janari i vitit 2016 në bazë të nenit 253 të KPPK-së janë hedhur gjithsej 8 aktakuza në shqyrtimin e dytë, duke qenë se këtë vit janë shpallur 19 aktgjykime liruese që të gjitha këto në mungesë të provave.

-Në Gjykatën Themelore në Gjiilan nga janari i vitit 2016 në bazë të nenit 253 të KPPK-së janë hedhur gjithsej 2 aktakuza në shqyrtimin e dytë, duke qenë se këtë vit janë shpallur 48 aktgjykime liruese që të gjitha këto në mungesë të provave.

-Në Gjykatën Themelore në Pejë – dega Istog nga janari i vitit 2016 në bazë të nenit 253 të KPPK-së është hedhur një aktakuzë, duke qenë se këtë vit po ashtu është shpallur vetëm një aktgjykim liruës në mungesë të provave.

Nga të dhënat e prezantuara në tabelë vërehet qartë se gjykatat kanë hedhur numër të vogël të aktakuzave, madje ka nga ato që nuk kanë hedhur asnjë aktakuzë, ndërsa nga ana tjetër kanë numër të madh të aktgjykimeve liruese në mungesë të provave.

Raporti konsideron se mos'hedhja e aktakuzave nga ana e gjykatës të cilat janë të pabazuara mirë në prova, ndikon drejtpërdrejt edhe në grumbullimin e lëndëve, në efikasitet, në besimin e qytetarëve në drejtësi dhe mbi të gjitha ndikon edhe në shpenzimet e panevojshme për buxhetin e Republikës së Kosovës.

Duke marrë parasysh se numri i prokurorëve është në rritje e sipër, aktakuzat e tyre duhet të jenë më të kompletuara. Nga ana tjetër, gjykatësve nuk duhet t'u mungojë guximi profesional për hedhje poshtë të aktakuzave të cilat nuk janë të bazuara mirë në prova.

## 5. TË METAT E LIGJIT TË TRASHËGIMISË NË KOSOVË

Derisa në të drejtën zakonore shqiptare, pozita e gruas ka qenë e diskriminuar në aspektin e së drejtës së trashëgimisë, ligji aktual për trashëgiminë i Kosovës njeh barazinë gjinore në trashëgimi.

Trashëgimia në Kosovë dhe e drejta për të trashëguar është e rregulluar me ligj.<sup>74</sup>

Sipas Ligjit për Trashëgiminë i Kosovës të gjithë personat fizikë në kushte të njëjta janë të barabartë në trashëgimi.<sup>75</sup> Gruaja në këtë Ligj bën pjesë si trashëgimtare në rendin e parë, atëherë kur ajo është bashkëshorte ose ka qenë në marrëdhënie jashtëmartesore me trashëgimlënësin për 10 vite dhe ka pasur një fëmijë brenda pesë (5) viteve.

Në rendin e dytë të trashëgimit ajo paraqitet atëherë kur është nëna e trashëgimlënësit. Ndërsa në rendin e tretë ajo paraqitet si trashëgimtare atëherë kur ajo është motra e trashëgimlënësit.

Neni 12, i Ligjit për Trashëgiminë i Kosovës, parasheh trashëgimtarët në radhën e parë të trashëgimisë.

“Trashëgimlënësin e trashëgojnë para të gjithëve fëmijët e tij dhe bashkëshorti i tij”<sup>76</sup>.

Ky nen duket të ketë paraqitur telashe në praktikë. Sipas këtij neni, trashëgimlënësin e trashëgojnë para të gjithëve fëmijët e tij dhe bashkëshorti i tij.

### Ligji aktual i trashëgimisë nuk e njeh gruan e djalit si trashëgimtare të pasurisë së vjehrrit.

Kjo zbrazëti ligjore u shfaq në gjykimin e çështjes së Shyhrete Berishës nga Suhareka, e cila humbi familjen gjatë luftës në Kosovë (burrin dhe katër fëmijët). Ajo tash 16 vite pas luftës po përballlet me procese gjyqësore në kërkim të pronës e cila po i mohohet nga familja e burrit.

Berisha, përmes proceseve gjyqësore po kërkon që ta gëzojë shtëpinë ku para luftës jetoi me burrin dhe fëmijët e saj. Mirëpo shtëpia ku çifti jetoi për shumë vite është e regjistruar në emër të vjehrrit, e jo në emër të burrit të saj.

Avokati mbrojtës i Shyhrete Berishës, është i mendimit se ligji aktual i trashëgimisë, është diskriminues në ndarjen e trashëgimisë për gratë.

Neni 12 i ligjit të trashëgimisë, sipas tij e diskualifikon Shyhreten nga e drejta e trashëgimisë.

“Pasi që pasuria ka qenë në emër të babait të burrit të Shyhrete Berishës, trashëgimtarë, sipas këtij neni, janë fëmijët dhe bashkëshortja vjehrrit të Shyhretes, por jo edhe reja-

<sup>74</sup> Ligji për trashëgiminë i Kosovës nr. 2004/26, I datës 4 shkurt 2005, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2407>

<sup>75</sup> Ligji për Trashëgiminë i Kosovës, neni 3.1

<sup>76</sup> Ligji për Trashëgiminë i Kosovës, neni 12.1

pra Shyhrete Berisha, pasi që me këtë kornizë ligjore reja në këtë rast nuk mund të jetë trashëgimtare e vjehrrit”.<sup>77</sup>

Raporti konsideron se të metat ligjore të hasura gjatë trajtimit të këtij rasti duhet të reflektojnë në ndryshimet ligjore sa i përket të drejtave të grave në trashëgimi, pasi ligji aktual nuk është i favorshëm dhe shkel të drejtat e grave. Kjo për faktin se në të ardhmen mund të ketë raste të tilla të ngjashme ku do të mund të ballafaqohemi sërish me dispozita të njëjta ligjore diskriminuese.

Në këtë rast diskriminimi ligjor ndaj grave paraqitet në aspektin juridik ngase nuk është konfytues fakti që bashkëshorti i Shyhrete Berishës së bashku me fëmijët kanë jetuar të ndarë në shtëpi nga anëtarët tjerë të familjes, mirëpo statusi juridik mbi pronësinë ka qenë dhe vazhdon të jetë në emër të vjehrrit të saj!



“Ligji ka nevojë të plotësohet dhe ndryshohet pikërisht për këto raste dhe unë si deputete jam për ndryshime në këtë ligj, pasi që po shkelen të drejta e grave në pronë”

LIRIE KAJTAZI

“Është shumë e padrejtë ndaj grave që kanë jetuar disa vite në shtëpinë e tyre me burrin dhe fëmijët, por që lufta ia mori të gjitha dhe tani ligji ta largojë nga shtëpia, pasi që nuk i’a njuh të drejtën në trashëgimi”<sup>78</sup>.

Në bazë të asaj që thuhet në këtë nen, vërehet qartë se në rastet kur vdes trashëgimtari, garantohet e drejta vetëm për fëmijët dhe pasardhësit e tyre, ndërsa askund nuk i garantohet kjo e drejtë edhe bashkëshortit/es.

Në rastin e Shyhrete Berishës, trashëgimtari i vjehrrit është burri i saj, ndërsa zëvendësimi i tij janë fëmijët, që në rastin konkret ajo nuk i ka. Pra ashtu siç është, ligji ia mohon të drejtën e saj në trashëgimi.

Duke pasur parasysh rastin e Shyhrete Berishës vërehen qartë mangësitë dhe diskriminimet ligjore, andaj Raporti konsideron se duhet të ndryshohet ligji në drejtim të garantimit të drejtave të grave në trashëgimi.

Deputetja Lirie Kajtazi, kryetare e Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Personat e Pagjetur dhe Peticione tha se rasti i Shyhrete Berishës është i njohur për deputetët dhe së bashku me grupin e grave deputete tha se janë duke bërë përpjekje me propozime për ndryshimet në këtë ligj.

“Ligji ka nevojë të plotësohet dhe ndryshohet pikërisht për këto raste dhe unë si deputete jam për ndryshime në këtë ligj, pasi që po shkelen të drejta e grave në pronë” Lirie Kajtazi.

Gjyqtari i gjykatës Themelore në Prizren, dega në Suharekë, Shaban Zeqiraj, i cili merret me rastet civile dhe poashtu është duke e gjykuar edhe rastin e Shyhrete Berishës, duke mos folur për rastin konkret, thotë se rastet e pronës ku femra është paditëse janë të ndjeshme për t’u gjykuar.

“Konfytet pronësore, ku femra është paditëse janë të ndjeshme për t’u gjykuar dhe unë i kushtoj një rëndësi më të veçantë, që ligji të zbatohet në përpikëri në këtë drejtim, pasi që shumica e femrave po heqin dorë nga palujtshmëria e trashëgimëlinësit në favor të vëllait,

<sup>77</sup> Intervistë me avokati Naim Qelaj.

<sup>78</sup> Intervistë me avokatin Naim Qelaj.

duke respektuar të drejtën zakonore, edhe pse ligji ia njuh të drejtën për të trashëguar” gjyqtari Shaban Zeqiraj.

Heqja dorë nga trashëgimi, sipas tij, duhet të ndryshohet nga ligji për trashëgiminë, pasi marrja e pjesës së trashëguar nga trashëgimtarët, do të krijonte një stabilitet të femrës në familje.

### Pak Femra Kërkojnë Trashëgiminë Pronësore me Gjyq!

Një problem tjetër i hasur në praktikë sa i përket Ligjit për Trashëgiminë në Kosovë ka të bëjë edhe me heqjen dorë të femrave nga trashëgimia.

Hulumtimi i bërë nga BIRN dhe I/KS në gjykatat e Kosovës për periudhën janar 2015 - maj 2016 tregon se një numër shumë i vogël i femrave e kërkojnë trashëgiminë pronësore përmes gjyqit.

Në Kosovë është i njohur fakti se femrat në numër të vogël kërkojnë në gjykatë realizimin e të drejtës së tyre për trashëgimi pronësore. Këtë fakt e vërtetojnë edhe të dhënat nga Agjencia e Statistikave sipas së cilës në vitin 2015 vetëm 5 për qind e grave në Kosovë kishin në pronësi të tyre shtëpi ose banesë.<sup>79</sup>

Nga hulumtimi i bërë në periudhën janar 2015 – maj 2016 gjykatat e Kosovës kanë pranuar vetëm 9 raste në të cilat janë të përfshira femrat në trashëgimi, nga numri i përgjithshëm prej 210 rasteve të trashëgimisë, përjashtuar këtu Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe atë të Mitrovicës nga të cilat nuk kemi marrë përgjigje për numrin e saktë të këtyre rasteve.

Ndryshe nga Prishtina dhe Mitrovica, pesë Gjykatat e tjera Themelore në vend e kanë bërë këtë ndarje dhe numri i rasteve të trashëgimisë pronësore të femrave në këto Gjykata është si më poshtë:

**Tabela me numrin e rasteve të trashëgimisë në gjykata:**

GJYKATA	FEMRAT NË TRASHËGIMI	NUMRI I RASTEVE TË PËRGJITHSHME
PRIZREN	6	122
FERIZAJ	0	2
PEJË	1	42
GJILAN	1	37
GJAKOVË	1	7
TOTAL	9	210

<sup>79</sup> <http://kallxo.com/vetem-5-per-qind-te-grave-kane-prone/>



“Kontestet pronësore, ku femra është paditëse janë të ndjeshme për t’u gjykuar dhe unë i kushtoj një rëndësi më të veçantë, që ligji të zbatohet në përpikëri në këtë drejtim, pasi që shumica e femrave po heqin dorë nga palujtshmëria e trashëgimtarëve në favor të vëllait, duke respektuar të drejtën zakonore, edhe pse ligji ia njuh të drejtën për të trashëguar”  
**SHABAN ZEQIRAJ,**  
**GJYQTAR**

Numri kaq i vogël i rasteve të trashëgimisë në gjykata është për faktin se tani qytetarët për trashëgimi po u drejtohen noterëve, pasi që kjo e drejtë u është njohur me ligj. Ligji për Noterinë e Kosovës Nr. 03/L- 010 i hyrë në fuqi në tetor të vitit 2008 në nenin 29 i njejtë noterëve trajtimin e të gjitha procedurave jokontestimore trashëgimore. Në këtë drejtim shumica e lëndëve të trashëgimisë, në përjashtim të atyre kontestimore, u drejtohen noterëve.



“Unë mendoj që palët duhet t’u drejtohen noterëve. Mirëpo nuk është keq që kjo kompetencë është edhe në kompetencë të gjykatave themelore dhe mirë është që kjo kompetencë është e dyanshme që palët varësisht nga koha apo mundësitë t’i zgjidhin sa më shpejt kërkesat e tyre”

**XHEMIL ELSHANI,  
GJYKATËSI**

Nga 74 Zyret Noteriale sa janë në Kosovë, Raporti ka arritur të sigurojë të dhëna rreth procedurave trashëgimore të zhvilluara vetëm në 5 prej tyre. Pranë pesë zyreve noteriale nga komuna të ndryshme të Kosovës për vitin 2015 janë shqyrtuar 625 lëndë të trashëgimisë, ndërsa për vitin 2016, nga po të njëjtat zyre noteriale janë shqyrtuar 797 lëndë të trashëgimisë, përderisa nuk kanë mundur të sigurohen të dhëna nga zyret tjera noteriale.<sup>80</sup>

Këto të dhëna tregojnë për numrin e madh të lëndëve të trashëgimisë të cilët u drejtohen zyreve të noterëve, karshi numrit të vogël të rasteve të trashëgimisë të proceduara në gjykata.

Mirëpo, ka gjyqtarë që mendojnë se palët edhe më tutje duhet t’u drejtohen gjykatave për të zgjidhur rastet e trashëgimisë.

“Unë mendoj që palët duhet t’u drejtohen noterëve. Mirëpo nuk është keq që kjo kompetencë është edhe në kompetencë të gjykatave themelore dhe mirë është që kjo kompetencë është e dyanshme që palët varësisht nga koha apo mundësitë t’i zgjidhin sa më shpejt kërkesat e tyre” gjykatësi për çështje trashëgimore, Xhemil Elshani.

Pavarësisht nga e drejta ligjore për heqje dorë nga trashëgimia, duke parë numrin e madh të rasteve kur femrat heqin dorë nga kjo e drejtë dhe duke pasqyruar faktin se statistikat tregojnë që vetëm 5% e pronës është e regjistruar në emër të grave, kjo shifër është shqetësuese.

Andaj Raporti konsideron se duhet të punohet më shumë në këtë drejtim dhe pos ndryshimeve ligjore duhet të bëhet fushatë më e madhe në drejtim të garantimit dhe realizimit të drejtave të femrave në trashëgimi.

<sup>80</sup> Erdon GjinoLli, udhëheqës i Shërbimit Administrativ, Oda e Noterëve të Republikës së Kosovës.

## 6. ZYRET PËR INFORMIM DHE TRANSPARENCA

Raporti gjatë vitit 2016 ka matur nivelin e transparencës së institucioneve të drejtësisë përmes komunikimit dhe njoftimit për media dhe qytetarë.

Marrë parasysh angazhimin e zyrtarëve për informim në polici, prokurori dhe gjykata, Raporti ka bërë krahasimin mes këtyre institucioneve sa i përket transparencës për publikun krahas llogaridhënies dhe kompetencave që kanë këto tri institucione. Në pamundësi të sigurimit të të dhënave për (mos)përgjigje nga kërkesat drejtuar këtyre institucioneve, vlerësimi është bërë vetëm duke u bazuar në aktivitetet dhe të dhënat që janë ofruar për publikun nga vetë këto institucione.

Nga të dhënat e siguruara, Policia e Kosovës del të jetë institucioni me më së shumti aktivitete të zyreve për informim, e pasuar nga gjykatat dhe krejt në fund prokuroritë.

### POLICIA E KOSOVËS

Policia e Kosovës, një ndër objektivat kyçe të cilës i ka kushtuar një rëndësi të veçantë gjatë vitit 2016 del të jetë transparenca dhe llogaridhënia ndaj institucioneve relevante, ndaj mediave dhe opinionit publik, për të cilën Policia e Kosovës vlerësohet si ndër institucionet më të besuara dhe më transparente në vend<sup>81</sup>.

Në strukturimin e saj, Policia e Kosovës ka përfshirë një zyre për komunikim në nivel qendror si dhe tetë zyre në nivele rajonale, me anë të së cilave edhe është dëshmuar përkushtimi i Policisë së Kosovës në transparencë.

Komunikimin me publikun Policia e Kosovës e ka të rregulluar në dy nivele;

#### 1) Zyra për komunikim në nivel qendror (Prishtinë) e cila ka këto njësi - ekupe;

Njësia për analizë të mediave, njësia e faqes së internetit dhe intranetit, njësia për komunikim me publikun dhe redaksia e revistës "Mbrojtësi".

#### 2) Zyrat për komunikim në nivel lokal/Rajone (8)

Baza ligjore e funksionimit të zyrave për informim; Ligji i Policisë, rregullorja Nr.04/2015, për bashkëpunimin e Policisë me media, strategjia e komunikimit me media e MPB-së, rregullorja lidhur me Mediat Sociale/është në përfundim, PSO-të (Procedurat Standarde të Operimit).

#### Nga të dhënat e siguruara del se detyrat ditore të Policisë së Kosovës janë:

Publikimi për media i raportit 24 orësh me ngjarjet dhe incidentet në të gjitha rajonet,

<sup>81</sup> Përgjigja e zyrës për informim e policisë së Kosovës: Këto vlerësime janë bërë nga faktorë të ndryshëm vendor dhe ndërkombëtarë duke përfshirë edhe organizata të ndryshme jo qeveritare, e së fundi edhe Transparency International..



mirëmbajtja e ueb-faqes, intranetit, Facebook të Policisë së Kosovës dhe publikimi i të gjitha informacioneve, analiza dhe përmbledhja e shtypit ditor, konferenca për media, komunikatat për media, intervista, prononcimet për media, fushatat vetëdijesuese, si dhe pjesëmarrja në debate të ndryshme publike. Në mungesë të të dhënave për nivelin e kthimit të informatës ndaj kërkesave të mediave, publikut dhe organizatave të ndryshme jo qeveritare, të dhënat e sigurara në vazhdim paraqesin numrin e komunikatave të lëshuara në të cilat Policia e Kosovës ka vendosur të jetë e hapur për publikun.

**Tabela me komunikatat e lëshuara nga Policia e Kosovës për vitin 2016:**

POLICIA E KOSOVËS	KOMUNIKATA
ZYRA QENDRORE	166
ZYRET RAJONALE	540
RAPORTI 24 H	335
TOTAL	1,041

Përpos komunikatave të lëshuara, kanë realizuar edhe intervista për radio dhe televizione, konferenca për gazetarë, paraqitje televizive si dhe aktivitete tjera

Nga të dhënat e paraqitura në tabelë, shihet se gjatë periudhës kohore të vitit 2016 deri më tani nga zyra për informim në nivel qendror të Policisë së Kosovës janë lëshuar 166 komunikata, 335 raporte 24 orëshe, ndërsa nga zyret për informim në nivele rajonale janë publikuar rreth 540 komunikata.

Duke marrë parasysh që Zyret për Informim të Policisë së Kosovës gjatë vitit, përpos komunikatave të lëshuara, kanë realizuar edhe intervista për radio dhe televizione, konferenca për gazetarë, paraqitje televizive si dhe aktivitete tjera, Raporti konsideron se Policia e Kosovës ka treguar performancë shumë të mirë sa i përket transparencës dhe llogaridhënies për publikun krahasuar me prokuroritë dhe gjykatat, gjithnjë duke u bazuar në të dhënat kuantitative të ofruarar ngë vet Policia e Kosovës.

## GJYKATAT

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duke përfshirë edhe të gjitha gjykatat e të gjitha niveleve në Kosovë, kanë gjithsej tetë zyrtarë për informim. KGJK ka një zyrtar për informim, një zyrtar për informim e ka Gjykata Supreme, një Gjykata e Apelit dhe pesë zyrtarë për informim janë nga Gjykatat Themelore, përderisa dy regjione të gjykatave themelore në Mitrovicë dhe Gjakovë nuk kanë të angazhuar fare zyrtarë për informim.

Duke pasur parasysh numrin e zyrtarëve për informim, Raporti ka mbledhur të dhëna statistikore sa i përket komunikimit me media dhe publikun nga ana e zyreve për informim nga janari deri në muajin dhjetor të vitit 2016.

## GJYKATAT

## KOMUNIKATA

KGJK	30
GJYKATA SUPREME	15
GJYKATA E APELIT	50
GJYKATA THEMELORE PRISHTINË	40
GJYKATA THEMELORE PRIZREN	50
GJYKATA THEMELORE PEJË	32
GJYKATA THEMELORE GJILAN	27
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ	35
GJYKATA THEMELORE MITROVICË	0
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË	0
TOTAL	279

“KGJK dhe gjykatat kanë  
lëshuar **279 komunikata**  
Policia ka lëshuar  
**1,041 komunikatave**”

Në mungesë të të dhënave për krahasimin e numrit të kërkesave për informata nga mediat, publiku dhe organizata e ndryshme jo qeveritare, nga të dhënat statistikore të siguruar nga KGJK dhe gjykatat, del se gjatë gjithë vitit 2016 të gjitha gjykatat së bashku me Këshillin Gjyqësor të Kosovës kanë lëshuar 279 komunikata, numër shumë më i vogël krahasuar me atë të policisë prej 1,041 komunikatave.

Për më tepër, komunikatat e lëshuara nga gjykatat janë me të dhëna të mangëta duke mos i kontribuar transparencës, për faktin se në rastet e marrjes së aktgjykimeve dënuese gjykatat lëshojnë komunikata duke mbuluar identitetin e personave të dënuar, gjë e cila shkakton probleme të mëdha në identifikimin e rasteve nga ana e mediave. Raportimin me iniciale të të dënuarve, zyret për informim të gjykatave e bazojnë në udhëzimin administrativ 02/2016 Për Anonizimin dhe Publikimin e Aktgjykimeve të Plotfuqishme.<sup>82</sup>

Raporti konsideron se ky udhëzim administrativ i nxjerrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës e cenon transparencën dhe, për më tepër, është në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, i cili pos pjesmarrjes në seanca të hapura për publikun dhe pos regjistrimit me audio dhe videoincizim zyrtar, lejon edhe fotografimin, filmimin dhe regjistrimin televiziv për media.

Marrë parasysh transparencën që garanton Kodi i Procedurës Penale dhe faktin që mediat i përcjellin dhe raportojnë nga seancat gjyqësore edhe me video incizim, është e pakuptueshme që gjykatat për të njëjtat raste në fund të raportojnë me iniciale duke fshehur identitetin e personave të dënuar.

Për më tepër, kur dihet fakti se gjykatat marrin aktgjykim “Në emër të Popullit” është i

82 file:///C:/Users/petriitk/Documents/Doënloads/Udhezim%20Administrativ%20per%20anonimizimin%20dhe%20publikimin%20e%20aktgjykimeve%20te%20plotfuqishme%20(1).pdf

pakuptueshëm vendimi për anonimizimin/fshehjen e emrave ndaj “popullit” në emër të të cilit merret vendimi.

## PROKURORIA

Sa i përket zyreve për informim, në gjendje më të rëndë qëndron Këshilli Prokurorial i Kosovës së bashku me prokuroritë.

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka dy zyrtarë për komunikim me media, ndërsa institucioni i Prokurorit të Shtetit ka një zyrtar për informim. Përderisa problemi më i madh i prokurorive është mungesa e zyrtarëve për informim të prokurorive themelore dhe asaj të Apelit. Raporti, sikurse për Policinë dhe gjykatat, ka nxjerrë të dhënat statistikore edhe për komunikatat e lëshuara nga institucioni i Prokurorisë së Shtetit.

### Tabela me të dhënat nga komunikatat e lëshuara nga institucionet e Prokurorisë së Shtetit:

POKURORIA	KOMUNIKATAT
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS	59
ZYRA E KRYEPROKURORIT TË SHTETIT	154
TOTAL	213

### Përfundim:

Raporti konsideron se për të rritur transparencën dhe llogaridhënien në sistemin gjyqësor dhe atë prokurorial të Kosovës duhet që këto institucione të angazhohen në rritjen e numrit të zyreve për informim.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të angazhojë zyrtarë për informim në Gjykatën Themelore të Mitrovicës dhe atë të Gjakovës.

Raporti i rekomandon Këshillit Prokurorial të Kosovës që të angazhojë zyrtarë për informim në shtatë prokuroritë themelore të Kosovës, atë të Apelit si dhe në Prokurorinë Speciale. Raporti konsideron se duhet të kontribuohet më shumë në përmirësimin e perceptimit publik të Prokurorit të Shtetit në Kosovë. Duhet të ngriten kapacitetet e Zyrës për Media të Prokurorisë së Shtetit, duke siguruar dhe ofruar trajnime të përshtatshme me nevojat e zyrtarëve për informim, si dhe duke rritur aftësitë e prezantimit gjatë paraqitjes publike të prokurorëve dhe kryeprokurorëve.

KPK dhe Prokuroria e Shtetit kanë nevojë për mbështetje konsistente dhe sistematike se si të ballafaqohen me raste të ndryshme kur publiku kërkon të informohet. Prandaj, në këtë drejtim nevojitet hartimi i një udhëzuesi të parimeve në plasimin e informacionit i cili do t’u ndihmonte prokurorëve të dijnë si të reagojnë në situata të caktuara.

Udhëzuesi do t’i mundësonte Prokurorisë që të përgjigjet ndaj nevojave të qytarëve për

t'u informuar në rrugë të përshtatshme dhe ligjore për të ruajtur punën profesionale të Prokurorisë së Shtetit, por gjithashtu ta kënaqë nevojën e publikut për informim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme.

Raporti, duke ndjekur vlerësimin e nevojave dhe evaluimin, konsideron se duhet të përgatiten trajnime me module për stafin e Zyrës për Media, Prokurorinë e Shtetit, Prokurorinë Speciale, si dhe Prokurorët e Prokurorive Themelore, me tema për paraqitjen publike, aftësitë intervistuese, përgatitjen e dokumenteve për media dhe ndërtimin e marrëdhënieve me gazetarë.

Raporti, në këtë drejtim, e sheh të nevojshme prodhimin dhe transmetimin e një emisioni, serie televizive të titulluar me emrin "Prokuroria".

Lansimi i një emisioni të tillë do të shërbente për të treguar eksperiencat reale të prokurorëve dhe sfidat e tyre në zgjidhjen e rasteve. Realizimi i një emisioni të tillë do të bëhej në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë e Shtetit në organizimin, filmimin, prodhimin dhe transmetimin e këtij segmenti që do t'i dedikohet punës në këtë institucion. Kjo, konsiderojmë se do të jetë mënyrë e shkëlqyeshme për të kontribuar në promovimin e rezultateve të Prokurorit të Shtetit dhe rritjes së besimit të publikut tek prokurorët.

## 6. SHKELJET TEKNIKE

BIRN dhe I/KS, me fillimin e projektit të monitorimit që nga viti 2008, trajtim të veçantë i ka kushtuar edhe trajtimin të problemeve teknike të cilat kanë qenë faktorë të cilët i kanë hapur rrugë problemeve tjera të përshkruara në vijim.

Probabiliteti që diçka të shkojë proceduralisht jo në rregull është shumë më i madh nëse p.sh. seancat gjyqësore nuk fillojnë me kohë, nuk respektohet kodi i veshjes, përdoren telefonat gjatë seancave gjyqësore që ndikon drejtpërdrejt në humbjen e koncentrimin, ose nëse gjykimet mbahen në zyrë të gjykatësit në vend se të mbahen në sallë të gjykimin, e po ashtu nëse gjykimi mbahet në sallë e nuk përdoret audio dhe video- incizimi zyrtar.

Përderisa në praktikë ende ballafaqohemi me tolerim të shkeljeve të vogla, duket të jetë e vështirë që të luftohen edhe shkeljet e mëdha. Shkeljet teknike shpeshherë kanë qenë dhe mbeten rruga e shtruar drejt shkeljeve procedurale.

Vitin e kaluar BIRN dhe I/KS vendosën që mos të merren me shkelje teknike, me qëllimin se shkelje të tillë të konsiderohen si diçka e fejkualuar, mirëpo duke parë gjendjen në teren, kemi vendosur që edhe këtë vit t'i rikthehemi monitorimit të seancave gjyqësore në gjykatat e rregullta dhe të shohim se a ka pasur shkelje teknike dhe deri në çfarë nivele kanë arritur ato.

BIRN dhe I/KS gjatë vitit 2016 kanë monitoruar 686 seanca gjyqësore, prej tyre kanë qenë 607 seanca nga lëmi penal, ndërsa 79 të tjera nga ai civil.

### SEANCAT GJYQËSORE

Civile	79	12%	Grand Total 686
Penale	607	88%	

77 për qind e seancave gjyqësore të monitoruara nga monitoruesit e BIRN dhe I/KS janë nga Departamenti i Krimeve të Rënda, ndërsa 23 për qind e tyre janë nga Departamenti i Përgjithshëm duke përfshirë rastet penale dhe ato civile, përderisa vetëm një rast është nga Departamenti për të Mitur.

### DEPARTAMENTET

Krime të rënda	528	77%	Grand Total 686
Përgjithshëm	157	23%	
Të mitur	1	0%	

Nga 686 seancat e monitoruara, 160 prej tyre nuk janë mbajtur ndërsa 526 seanca gjyqësore janë mbajtur. Numri prej 526 seancave gjyqësore do të jetë mostër për matjen e të gjeturave nga shkeljet teknike në vazhdim.

## A ËSHTË MBAJTUR SEANCA GJYQËSORE?

Jo	160	23%	Grand Total 686
Po	526	77%	

Gjatë vitit 2016, seancat gjyqësore kanë vazhduar të lajmërohen si në monitorët e vendosur në hyrje të gjykatës, ashtu edhe përmes internetit, në ueb faqet e gjykatave. Nga 526 seancat e monitoruara, 370 kanë qenë të lajmëruara, përderisa 156 prej tyre nuk kanë qenë të lajmëruara fare. Numri i seancave gjyqësore të palajmëruara edhe këtë vit del të jetë i lartë, në 30 për qind të seancave të monitoruara seancat nuk kanë qenë të lajmëruara edhe përkundër faktit se gjykatat tani kanë të angazhuar zyrtarët për informim.

Trajektorja e matjeve të BIRN dhe I/KS prej vitit 2010 e deri në vitin 2016 e lajmërimit të seancave gjyqësore në tabelën e shpalljeve duket si më poshtë:

## A KA QENË E LAJMËRUAR SEANCA GJYQËSORE?

Jo	156	30%	Grand Total 526
Po	370	70%	

## LAJMËRIMI NË TABELËN E SHPALLJEVE




Tabela në vijim, pasqyron seancat gjyqësore që kanë filluar me kohë dhe ato që kanë filluar me vonesë gjatë vitit 2016.

## A KA FILLUAR SEANCA GJYQËSORE ME KOHË?

Jo	<b>154</b>	<b>29%</b>	} <b>Grand Total</b> <b>526</b>
Po	<b>372</b>	<b>71%</b>	

Ndër vite shumë seanca gjyqësore janë mbajtur nëpër zyre të gjyqtarëve në vend se të mbahen në sallat e gjykimit, andaj vendi i mbajtjes së seancave gjyqësore në vazhdimësi ka qenë objekt i interesit të monitorimit të BIRN dhe I/KS.

Sipas të dhënave që dalin nga monitorimi ynë, del se në 85 për qind të rasteve seancat gjyqësore janë mbajtur në sallën e gjykimit, ndërkaq 15 për qind e tyre janë mbajtur në zyre të gjykatësit, duke e paraqitur edhe më tej si problem shqetësues mosmbajtjen e seancave gjyqësore në sallë të gjykimit dhe me këtë mos dhënie e mundësisë për transparencë ndaj publikut.

## KU ËSHTË MBAJTUR SEANCA GJYQËSORE?

Sallë të gjykatës	<b>449</b>	<b>85%</b>	} <b>Grand Total</b> <b>526</b>
Zyre	<b>77</b>	<b>15%</b>	

Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial janë kujdesur që të sigurojnë uniforma për të gjithë gjykatësit dhe prokurorët. Të njëjtën gjë e ka bërë edhe Oda e Avokatëve të Kosovës. Mirëpo në realitet, në 11 për qind të seancave të monitoruara gjatë vitit 2016 nuk është përdorur uniforma.


Trajektorja e matjeve të Raportit prej vitit 2010 e deri në vitin 2016 e mospërdorimit të uniformave duket si më poshtë:

## A ËSHTË PËRDORUR UNIFORMA?

Numrin më të madh të mos përdorimit të uniformave e përbëjnë avokatët, të pasuar nga prokurorët dhe në fund edhe nga vetë gjykatësit.

Jo	<b>56</b>	<b>11%</b>	} <b>Grand Total</b> <b>526</b>
Po	<b>470</b>	<b>89%</b>	

## MOS-PËRDORIMI I UNIFORMAVE



Nga 11 për qind e seancave të monitoruara, apo nga 56 seancat gjyqësore numrin më të madh të mos përdorimit të uniformave e përbëjnë avokatët, të pasuar nga prokurorët dhe në fund edhe nga vetë gjykatësit.

## NGA KUSH NUK ËSHTË PËRDORUR UNIFORMA?

Avokati	23	41%	Grand Total 56
Prokurori	18	32%	
Trupi gjykues	15	27%	


Duke qenë se gjatë seancave gjyqësore prezentë janë palë të ndryshme, duke nisur nga trupi gjykues/gjyqtari individual, avokatët, prokurorët, policia dhe publiku, edhe këtë vit Raporti ka bërë monitorimin e përdorimit të telefonave. Nga seancat e monitoruara në 10 për qind të tyre edhe në vitin 2016 janë përdorur telefonat.

**Trajektorja e matjeve të Raportit prej vitit 2010 e deri në vitin 2016 e përdorimit të telefonave duket si më poshtë:**

## A ËSHTË PËRDORUR TELEFONI?

Jo	474	90%	Grand Total 526
Po	52	10%	

## PËRDORIMI I TELEFONAVE





Nga 10 përqindëshi i përdorimit të telefonave, apo nga 52 seancat gjyqësore të monitoruara gjatë vitit 2016 në të cilat është përdorur telefoni, përqindjen më të madhe të përdoruesve e bëjnë avokatët, të pasuar nga prokurorët dhe vetë gjyqtarët. Ndërsa pjesën tjetër e përbëjnë palët tjera në procedurë duke përfshirë policinë dhe publikun.

## NGA KUSH ËSHTË PËRDORUR TELEFONI?

Avokati	15	29%	Grand Total 52
Dëshmitari	2	4%	
Gjyqtari	10	19%	
Palët në procedurë	5	10%	
Polici	1	2%	
Prokurori	13	25%	
Publiku	6	12%	

Audio dhe video- incizimi i seancave gjyqësore del të jetë njëra nga të gjeturat më brengosëse të vitit 2016. Në 95 për qind të seancave të monitoruara nuk janë përdorur pajisjet për regjistrim zyrtar të seancave gjyqësore.


Mos-shfrytëzimi i mundësisë për incizim të seancave gjyqësore, e cila përcaktohet edhe me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës,<sup>83</sup> shpie në mos-përfilljen e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, edhe përkundër faktit se gjykatat kanë përgatitje për ta bërë një gjë të tillë.

**Trajektorja e matjeve të Raportit prej vitit 2010 e deri në vitin 2016 e mos-incizimit të seancave gjyqësore duket si më poshtë:**

## A ËSHTË PËRDORUR AUDIO DHE VIDEO-INCIZIMI NË SEANCËN GJYQËSORE?

Jo	502	95%	Grand Total 526
Po	24	5%	

## MOS INÇIZIMI I SEANCAVE



<sup>83</sup> Shih neni 208 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

Raporti gjatë vitit 2016 përmes monitoruesve me përvojë të gjatë në monitorimin e gjykatave, duke parë pasivitetin e gjyqtarëve kur ata janë anëtarë të trupit gjykues, ka bërë edhe matjen e aktivitetit të tyre në rolin e anëtarit të trupit gjykues.

Shpeshherë gjyqtarë me përvojë të gjatë dhe të përkushtuar në punë kur është në pyetje emri i tyre, në gjykimet kur ata veprojnë të vetëm, janë shumë aktivë ndërsa kur të njëjtit angazhohen në trupe gjyquese duket si një fenomen i kthyer në shprehi që ata t'i kaplojë pasiviteti.

Nga matjet e bëra nga monitoruesit e Raportit, nga 526 seancat gjyqësore të mbajtura në 22 për qind të seancave, gjyqtarët del të kenë qenë aspak aktivë duke mos parashtruar asnjë pyetje, në 14 për qind të rasteve kanë qenë mesatarisht të angazhuar, ndërsa në vetëm 4 për qind të rasteve ata kanë qenë shumë aktivë.

## SA KANË QENË AKTIVË ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES?

Aspak	<b>115</b>	22%	Grand Total <b>526</b>
Mesatarisht	<b>76</b>	14%	
Nuk ka pasur anëtarë të trupit gjykues	<b>217</b>	41%	
Pak	<b>99</b>	19%	
Shumë	<b>19</b>	4%	

## TELEFONAT E SHTRENJTË TË DREJTËSISË

Vitin 2016 e karakterizoi shfrytëzimi i buxhetit të shtetit për blerjen e telefonave të shtrenjtë në institucionet e drejtësisë.

Listës së institucioneve u parapriu Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, e cila në shkurt të vitit 2016 bleu telefona të mençur në vlerë të përgjithshme prej 7 mijë e 950 euro.<sup>84</sup>

Në thirrjen për kontratë thuhet se Gjykata planifikoi të blejë 10 telefona të mençur.<sup>85</sup> Sipas përlllogaritjes i bie që një telefon kësaj Gjykate i kushtoi 795 euro.

Pas dhjetë muajsh një tjetër telefon i mençur u ble nga një gjykatë në Kosovë. Kësaj radhe është Gjykata Themelore e Mitrovicës ajo që bleu një telefon në vlerë 995 euro.



“Më shumë kisha pasur dëshirë të rregullohet kjo çështje sesa të ma blejnë një telefon”

**ALI KUTLLOVCI,  
GJYKATËS**

Njoftimin për nënshkrimin e kontratës “Furnizim me Pajisje të Telefonisë Mobile- Një (1) Telefon Mobil”, Gjykata Themelore në Mitrovicë e publikoi në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik më 7 dhjetor.

I pari i Gjykatës Themelore të Mitrovicës, Ali Kutllovci, tregoi se gjykatës nuk po i funksionojnë e-mailat kohëve të fundit dhe se do të donte më shumë që të rregullohej kjo çështje se t'i blihej telefon.

“Më shumë kisha pasur dëshirë të rregullohet kjo çështje sesa të ma blejnë një telefon,” tha Kutllovci.<sup>86</sup>

Në përgjigjen për BIRN dhe I/KS, Kutllovci tha se Gjykata të cilën e udhëheq ai, ka edhe mungesa të tjera siç janë fotokopja dhe printerat.<sup>87</sup>

Edhe Ministria e Drejtësisë u është bashkuar institucioneve të tjera shtetërore që buxhetin e shtetit e shfrytëzojnë për të blerë gjëra luksoze.

Në faqen zyrtare të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP), Ministria e Drejtësisë më 1 dhjetor të vitit 2016 ka publikuar njoftimin për nënshkrimin e kontratës në vlerë prej 4 mijë e 128 euro për blerjen e telefonave të mençur për nevojat e saj.

Ministria e Drejtësisë me paratë e buxhetit bleu 6 telefona “Samsung” në vlerë 4,128 euro. Sipas njoftimit për nënshkrimin e kontratës, del që Ministria pagoi 688 euro për një telefon.<sup>88</sup>

84 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=1&CiID=VieëNotices&ID=113258>

85 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=1&CiID=VieëNotices&ID=112859>

86 <http://kalxo.com/gjykata-ne-mitrovice-blen-telefon-995-euro/>

87 Intervistë me Ali Kutllovcin, 07.03.2017

88 <http://kalxo.com/mbi-4-mije-euro-telefona-per-kabinetin-e-ministres-hoxha/>

Institucioni që shpenzoi më së shumti në blerjen e telefonave ishte Këshilli Gjyqësor i Kosovës, i cili ka shpenzuar hiq më pak se 20 mijë 700 euro për blerjen e 25 telefonave mobilë.

Procedura për blerjen e këtyre telefonave ishte iniciuar në muajin maj të vitit 2016, ndërsa njoftimi për kontratë ishte shpallur më 17 qershor 2016.

Nga njoftimi i publikuar në faqen zyrtare të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik – KRPP, shihet se kontrata është nënshkruar më 2 gusht 2016.

BIRN dhe I/KS kanë bërë përpjekje që të mësojnë më shumë për llojin dhe specifikat e pajisjeve telefonike të blera nga KGJK-ja, por nuk ka pranuar përgjigje nga këta të fundit, lidhur me markën e këtyre telefonave si dhe për personat të cilët do t' i shfrytëzojnë ato.<sup>89</sup> Sipas një llogaritjeje të kostos së përgjithshme të këtij tenderi prej 20,700 euro dhe sasisë prej 25 copë telefonash të përshkruar në njoftimin për këtë kontratë, rezulton se një telefon i ka kushtuar KGJK-së 828 euro.

Edhe për vitin 2017, Gjykata Kushtetuese sërisht mori hapin e para për blerje të telefonave mobilë. Në faqen zyrtare të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), Gjykata Kushtetuese ka publikuar njoftimin për kontratë në bazë të së cilës planifikon të blejë telefona të mençur.

Sipas thirrjes për kontratë, Kushtetuesja planifikoi të paguajë deri në 3 mijë e 500 euro për telefona mobilë. Bazuar në përgjigjen e ofruar nga kjo Gjykatë dhe në një përllogaritje të thjeshtë i bie që për gjashtë telefona planifikohen të shpenzohen deri në 583 euro për një telefon. Në anën tjetër Gjykata Kushtetuese ka qenë e rezervuar për të dhënë informacione se kush do të jenë shfrytëzues të këtyre telefonave mobilë.

#### Tabela me numrin dhe çmimin e telefonave të blerë;

INSTITUCIONI	SASIA E TELEFONAVE	ÇMIMI
GJYKATA KUSHTETUESE	10	7.950 EURO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË	1	995 EURO
MINISTRIA E DREJTËSISË	6	4.128 EURO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS	25	20.700 EURO
GJYKATA KUSHTETUESE	6	3.500 EURO
TOTAL:	48	37.273 EURO

89 <http://kallxo.com/keshilli-gjyqesor-shpenzon-20700-euro-per-25-telefona/>

Përderisa institucionet e drejtësisë shpenzojnë shuma të mëdha parash nga buxheti i shtetit për blerjen e telefonave të mençur, pikërisht këto institucione kanë mungesa të gjërave elementare për punë.

Sipas të dhënave zyrtare nga gjykatat, janë evidentuar këto mangësi:

Gjykata Themelore në Mitrovicë ka mungesë të skanerëve, printerëve dhe fotokopjeve. Gjykata Themelore në Gjiçan, në vitin 2016, është ballafaquar me mungesë të printerëve, fotokopjeve dhe kompjuterëve. Mungesa me kompjuterë këtë gjykatë e përcjellë edhe në vitin 2017.

Gjykata Themelore Gjakovë ka mungesë në mobile, karrige si në sallatë gjyqimorë, po ashtu edhe në kabinete. Kësaj gjykate i mungojnë edhe printerët e mjaftueshëm. Të njëjtin problem me Gjykatën Themelore në Gjakovë e kanë edhe degët e kësaj gjykate, ajo në Malishevë dhe Rahovec.

Ndërsa Gjykata Themelore në Ferizaj ka probleme me hapësirat të cilat i ofron objekti aktual. Sipas përgjigjes së kësaj gjykate, hapësirat nuk janë të përshtatshme për punë dhe për këtë Departamenti i Përgjithshëm funksionin e punës e ka kryer në objektin e marrë me qera.

Raporti konsideron se institucionet e drejtësisë duhet të kujdesen që ta shpenzojnë buxhetin e Kosovës në mënyrë sa më racionale duke i dhënë prioritet kërkesave dhe mungesave elementare për punë para se të vendosin për të blerë pajisje luksi.

Përderisa ka mungesa elementare për punë në gjykatat themelore të Kosovës, siç janë printerët, skanerët, fotokopjet e kompjuterët, është e pakuptueshme dhe jo e drejtë që në të njëjtën kohë institucionet e drejtësisë të pajisen me telefona mobilë, të cilët më shumë mund të konsiderohen pajisje luksi se sa pajisje që do të ndihmonin në mbarëvajtjen e punës në këto institucione.

## REKOMANDIMET

### 1. KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Të ndërmarrë masa ligjore nëpërmjet zyrës për vlerësimin e performancës ndaj prokurorëve të cilët nuk arsyetojnë si duhet kërkesat për caktimin e masës së paraburgimit;

Të aplikohet instituti i negociimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë;

Të referohen çështjet në procedurën e ndërmjetësimit;

Të ndërmerren masa ndëshkimore ndaj prokurorëve të cilët paraqiten të papërgatitur në seancë gjyqësore;

Të mos lejohen shkelje procedurale gjatë përfaqësimit të prokurorëve në seanca gjyqësore;

Të ndërmarrë masa ndaj prokurorëve të cilët nuk paraqiten në gjykim dhe të cilët nuk arsyetojnë mos prezencën e tyre në gjykatë;

Të sigurohet numër i mjaftueshëm i bashkëpunëtorëve profesionalë për prokurorët, së paku një bashkëpunëtor profesional për dy prokurorë;

Të angazhohen zyrtarë për informim nëpër prokuroritë themelore dhe atë të Apelit;

Të rritet numri i prokurorëve, krahas numrit të gjyatarëve;

### 2. KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

Të arsyetohen detajisht dhe me shkrim vendimet për caktimin e masës së paraburgimit;

Të aplikohet dorëzania si masë alternative për sigurinë e prezencës së të pandehurit në procedurë;

Të përshpejtohet zgjidhja e rasteve me paraburgim;

Të rritet numri i gjyqtarëve, pasi buxheti i KGJK-së lejon 404 gjyqtarë. Këtij numri duhet shtuar edhe numrin e gjyqtarëve që janë të paraparë me Marrëveshjen e Brukselit. Sot aktualisht në Republikën e Kosovës janë 346 gjyqtarë.

Të rritet numri i bashkëpunëtorëve profesionalë. Së paku një bashkëpunëtor profesional për dy gjykatës;

Të angazhohet zyrtarë për informim në të gjitha gjykatat themelore;

Të angazhohen praktikantë me pagesë në gjykatë;

Të merren masa ndëshkimore ndaj të gjitha rasteve ku dëshmohet përbërja jo e plotë e trupit gjykues;

Të merren masa ndëshkimore ndaj gjyqtarëve për mos respektimin e afatave ligjore në caktimin e seancave nga shyrtimi fillestar në shqyrtimin e dytë gjyqësor;

Të aplikohet instituti i negociimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë;

Të mos hezitohet hedhja poshtë e aktakuzave të prokurorisë në rastet kur nuk ka bazë për të vazhduar më tutje në shqyrtim gjyqësor;

T'i referojë çështjet në procedurën e ndërmjetësimit;

Të ndërmerren masa ndaj gjyqtarëve të cilët lejojnë shkelje procedurale;

Të ndërmarrë masa ndaj gjyqtarëve të cilët nuk mbajnë rendin në gjykatore;

Të ndërmarrë masa ndaj gjyqtarëve të cilët nuk konstatojnë gjendjen reale në procesverbal;

Të sigurojë monitorë në salla të gjykimit për të gjithë anëtarët e trupit gjykues, si dhe për prokurorin e mbrojtjen;

Të incizohen seanca gjyqësore në audio dhe video;

### **3. MINISTRISË SË DREJTËSISË**

Të fuqizojë përpjekjet dhe avokimin në Qeverinë/Kuvendin e Kosovës për rritjen e buxhetit të KGJK-së dhe KPK-së në mënyrë që të krijohen kushtet e nevojshme për angazhimin e bashkëpunëtorëve profesionalë, praktikantëve me pagesë dhe të zyrtarëve për informim;

### **4. POLICISË SË KOSOVËS**

T'u jepet prioritet dhe të mos ketë vonesa në kallëzimet penale të dërguara në prokurori;

### **5. KUVENDIT TË KOSOVËS**

Ta rrisë buxhetin për Këshillin Gjyqësor dhe atë Prokurorial;

### **6. GJYKATAVE**

Të mos caktohen disa seanca gjyqësore në të njëjtën ditë për një gjykatës pa pasur koordinim të duhur të kohës;

Të mbajnë rendin dhe qetësinë gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore;

T'i ndër marrë masat në lidhje me shtyrjen e seancave në distancë të madhe kohore nga njëra-tjetra;

Të sigurohen për mbajtjen e seancave gjyqësore me përbërje të plotë të trupit gjykues;

Gjyqtarët të jenë më aktivë në rastet kur ata janë anëtarë të trupeve gjykuese;

Të kujdesen për respektimin e afatave ligjore në caktimin e seancave nga shyrtimi fillestar në shqyrtimin e dytë gjyqësor;

Të arsyetohen vendimet për caktimin e masës së paraburgimit;

Të aplikohet dorëzania si masë alternative për sigurinë e prezencës së të pandehurit në procedurë;

Të përshpejtohet zgjidhja e rasteve me paraburgim;

Të aplikohet instituti i negocimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë;

Të referohen çështjet në procedurën e ndërmjetësimit;

### **7. PROKURORISË SË SHETIT**

Përgatitje më e lartë dhe përfaqësim më efikas i objektit të aktakuzës duke kontribuar kështu në vendosjen e drejtësisë dhe ruajtjen e buxhetit të shtetit;

Kujdesi i shtuar i prokurorëve gjatë mbarëvajtjes së procesit gjyqësor;

Të kujdeset për arsyetimin e kërkesave të prokurorëve për caktimin e masës së paraburgimit;

Të aplikohet instituti i negocimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë;

Të referohen çështjet në procedurën e ndërmjetësimit;

### **8. ZYRËS SË PROKURORIT DISIPLINOR**

T'i nisin procedurat disiplinore për gjykatës dhe prokurorë të cilët është konstatuar në këtë raport se kanë kryer shkelje të procedurave dhe kodit të etikës;

Të krijojnë mekanizma të cilët sigurojnë një mbikqyrje më të mirë të sistemit të drejtësisë nga ZPD;

## 9. SHËRBIMIT KORREKTUES TË KOSOVËS

T'i zbatojë urdhëresat e gjykatës për sjelljen me kohë të të pandehurve në seancat gjyqësore;





